VENDIM
Nr. 1, datë 17.1.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahimi	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.1.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 17 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Sali Berisha, përfaqësuar nga avokatët Klodiana Gjyzari dhe Genc Gjokutaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Arben Kraja.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Legjislativ, Merita Qato.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 520, datë 30.12.2023 dhe nr. 521, datë 27.12.2023, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-667 (94), datë 9.4.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 18, 27, 29, 42, 46, pika 1, 70, pika 1, 73, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, pika 1, shkronjat "b" dhe "c", 6, 7, 8, 10, 14, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 9, 14, 15, 25 dhe 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të ratifikuar me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike"; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Sali Berisha (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, u njoh me aktet e paraqitura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), i cili nuk ka mbajtur qëndrim për çështjen, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është aktualisht një politikan, drejtues i partisë kryesore opozitare dhe deputet i Kuvendit, si dhe ish-president dhe ish-kryeministër. Mbi bazën e një kallëzimi për kryerjen e disa veprave penale nga funksionarë të lartë shtetërorë, të bërë nga shtetasi T.B., i cili në atë kohë ka qenë kryetari i grupit parlamentar të partisë në pushtet, Prokuroria e Posaçme në vitin 2020 ka regjistruar procedimin penal nr. 287 për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (*KP*). Objekti i kallëzimit dhe i hetimit në vijim lidhet me procesin e kthimit të pronës në favor të 5 familjeve ish-pronare, procesin e privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish-klubit sportiv "Partizani"), procesin e ndryshimit të destinacionit dhe, më pas, edhe të zhvillimit të pronës.

2. Me urdhrin e datës 2.10.2023 prokurorët e çështjes kanë shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe emrin e kërkuesit, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", në bashkëpunim me shtetasit J.M. dhe F.B., të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së. Për sa i përket kërkuesit, faktet penale objekt hetimi lidhen me sjelljen e dyshuar të tij gjatë kohës kur ai ka ushtruar funksionin e Kryeministrit, pas vitit 2005, në proceset e kthimit të pronës, të privatizimit të pronës shtetërore (objekteve të klubit sportiv "Partizani" në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Klubit Shumësportesh Partizani në varësi të Ministrisë së Kulturës), të ndryshimit të destinacionit dhe të zhvillimit të pronës, duke favorizuar shtetasit J.M., F.B. e XH.B., ku këta të fundit dhe shoqëria e lidhur me ta kanë realizuar ndërtimin e një blloku pallatesh. Për këto procese dyshohet se janë dhënë dhe marrë përfitime monetare, paligjshmëria në origjinën e të cilave është fshehur nëpërmjet veprimeve financiare, transaksioneve të copëzuara ose në *cash*.

3. Në datën 16.10.2023, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) kërkesën për caktimin e masave të sigurimit personal ndaj personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin, për të cilin është kërkuar vendosja e masave të sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit",* të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Sipas Prokurorisë së Posaçme, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova, se nga ana e kërkuesit, në ushtrim të pushtetit të tij si Kryeministër, janë kryer veprime konkrete dhe aktive në drejtim të: përgatitjes dhe miratimit të projektligjeve dhe të projektvendimeve të qeverisë, në bashkëpunim me aleatët e vet politikë, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familjet ish-pronare, ku përfitues i drejtpërdrejtë ishte edhe shtetasi J.M., bashkëshorti i vajzës së tij; kryerjes së kontrolleve administrative, duke shfrytëzuar kompetencat e vartësve të tij, me qëllim ushtrimin e presionit dhe dhënien e urdhrave konkrete për veprime që duhet të kryenin funksionarët që pengonin procesin e privatizimit të klubeve sportive në favor edhe të shtetasit J.M.; vendosjes në dispozicion të shtetasit J.M. të strukturave të ndryshme të administratës shtetërore për realizimin e procesit të kthimit të pronës, privatizimit të pronës shtetërore dhe ndryshimit të destinacionit të pronës edhe në favorin e këtij shtetasi. Po ashtu, sipas Prokurorisë së Posaçme, përfitimi i parregullt në favor të shtetasit J.M. lidhet me dyshimin se të gjitha këto procedura, pavarësisht interesit publik në lidhje me nevojën për ambiente sportive, janë bërë me qëllimin e vetëm për të shtënë në dorë pronën dhe për ta përdorur atë për përfitime materiale, ku si të tilla janë konsideruar të gjitha ato përfitime monetare që ky shtetas ka marrë përmes shoqërisë ndërtuese, konkretisht nga shpërndarja e fitimeve të saj të akumuluara ndër vite përpara se ai të deklarohej bashkortak i saj, të llogaritura në shumën 672,976,832 lekë ose 5,420,345 euro.

4. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, gjyqtari i hetimeve paraprake, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 (*vendimi nr. 112/2023*), ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar për kërkuesin masat e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të KPP-së. Me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 (*vendimi nr. 117/2023*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka disponuar me vazhdimin e këtyre masave. Ky vendim është miratuar nga Gjykata e Posaçme e

Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

5. Ndërkohë, një prej detyrimeve të masave të sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së të Shkallës së Parë, të konfirmuar me vendimin nr. 117/2023 të kësaj të fundit, konkretisht "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", nuk është përmbushur prej tij (kërkuesit). Në këtë rast, referuar procesverbaleve të datave 6.11.2023, 20.11.2023, 4.12.2023 dhe 18.12.2023, të mbajtura nga oficeri i Policisë Gjyqësore, për paraqitjen e kërkuesit, rezulton se ky i fundit nuk është paraqitur në asnjë nga këto data. Për këtë arsye, Prokuroria e Posaçme, me argumentin se nga ana e kërkuesit nuk janë zbatuar këto vendime, për shkak se ai nuk ka ekzekutuar detyrimet e vendosura për të, konkretisht të paraqitej në Policinë Gjyqësore, me kërkesën nr. 16688 prot., datë 12.12.2023 dhe relacionin bashkëlidhur saj, bazuar në nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, i ka kërkuar Kuvendit dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit për zëvendësimin e masave të sigurimit personal nga "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", në atë të "Arrestit në burg/shtëpi", të parashikuara nga nenet 237 dhe 238 të KPP-së.

6. Për këtë arsye, në datën 18.12.2023 është zhvilluar mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (*Këshilli*), në të cilën kanë qenë të pranishëm dhe kanë shprehur qëndrimet e tyre, përveç deputetëve anëtarë të Këshillit, edhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe mbrojtësit e kërkuesit. Në përfundim të kësaj mbledhjeje, Këshilli ka vendosur t'i rekomandojë seancës plenare pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit.

7. Po ashtu, Kuvendi, i mbledhur në seancë plenare në datën 21.12.2023, me vendimin nr. 127, datë 21.12.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit. Në datën 22.12.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë (gjyqtarit të hetimeve paraprake) kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, e cila është pranuar me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023 të asaj gjykate (*vendimi nr. 520/2023*), duke u caktuar ndaj kërkuesit masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" dhe duke u urdhëruar kërkuesi të mos largohet nga banesa e tij, si edhe të mos komunikojë me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të.

8. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimet që vijnë si rezultat i zbatimit të vendimeve nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të po asaj gjykate, duke mos u paraqitur asnjëherë përpara Policisë Gjyqësore. Sipas asaj gjykate, ekziston "dyshimi i arsyeshëm", i bazuar në prova, kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, i KPP-së), se ai është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se nuk ka zbatuar në mënyrë të përsëritur detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore/hetuesit dhe duke mos paraqitur asnjë arsye të qenësishme që të justifikojë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar, gjithashtu, se në rastin konkret nevojat e sigurimit vijojnë të jenë në të njëjtin stad, por duke qenë se nga ana e kërkuesit, në mënyrë të përsëritur, janë shkelur detyrimet lidhur me zbatimin e masave të sigurimit personal të caktuara nga gjykata, në raport me parashikimet e nenit 228, pika 3, të KPP-së, jemi para kushteve kur duhet të zëvendësohen masat e sigurimit të dhëna ndaj tij me një masë tjetër më të rëndë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuesit, lidhur me rrezikun e dëmtimit të provave për sqarimin e fakteve penale, janë të tilla që justifikojnë masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", për shkak të funksionit që ka ushtruar më parë shtetasi nën hetim në kohën e kryerjes së veprës penale, por edhe të funksionit të tij aktual si deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistojnë ende rrethanat që kërkuesi mund të largohet. Për këto

arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke marrë në konsideratë mosrespektimin e urdhërimeve të gjykatës nga kërkuesi, të përcaktuara në vendimin e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj tij, të shoqëruar edhe me ekzistencën e kushteve dhe kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të normuara në nenin 228 të KPP-së, ka vlerësuar se justifikohet zëvendësimi i masave të sigurimit personal nga "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" me masën "Arresti në shtëpi".

9. Mbi ankimin e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 520/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për kontrollin e ligjshmërisë së autorizimit të dhënë nga Kuvendi i Shqipërisë janë të pabazuara, pasi dalin jashtë juridiksionit gjyqësor dhe posaçërisht atij penal, respektimi i të cilit është thelbësor për të garantuar paanshmërinë dhe drejtësinë e gjykimit, për shkak se gjykatat në këtë rast verifikojnë vetëm nëse ky autorizim i kërkuar është dhënë. Bazuar në përcaktimet e nenit 231 të KPP-së, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar, njësoj si GJKKO-ja e Shkallës së Parë, se kërkuesi ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij. Edhe GJKKO-ja e Apelit, njësoj si GJKKO-ja e Shkallës së Parë, ka konsideruar se masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi" është në përputhje me kërkesat e nenit 229, pika 2, të KPP-së, që i referohet kriterit të proporcionalitetit, ose përzgjedhjes së masës së sigurimit personal në raport të drejtë mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale të atribuar ose dënimit të mundshëm. Lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave të kërkuesit në kufizim të lirisë së tij të komunikimit dhe së drejtës së shprehjes, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në respektim të kufijve diskrecionalë të caktuar nga pika 2 e nenit 237 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka përzgjedhur një kufizim që është proporcional dhe i motivuar nga interesi publik që prevalon mbi interesin personal të individit. Në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit, GJKKO-ja e Apelit lidhur me kërkesën/pretendimin e kërkuesit për cenimin e pavarësisë dhe paanësisë nga gjyqtarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë, dhe të rrëzuar nga një gjyqtare tjetër e së njëjtës gjykatë, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, e ka vlerësuar si të bazuar rrëzimin e asaj kërkese. Sipas GJKKO-së së Apelit të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera të kërkuesit në lidhje me njëanshmërinë e gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë. Në vlerësimin e GJKKO-së së Apelit e gjithë procedura e ndjekur nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, për caktimin e gjyqtares që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtares nga shqyrtimi i çështjes, është në përputhje me përcaktimet e ligjit procedural penal dhe kërkesat ligjore të dispozitave të neneve 18 dhe 19 të KPP-së. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-667 (94), datë 9.4.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024 të GJKKO-së së Apelit. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, gjykatat më të ulëta kanë interpretuar drejt ligjin, duke zbatuar të njëjtat procedura e garanci, sikurse edhe në rastet e tjera të ankimimit kundër masave të sigurimit (neni 249), përfshirë këtu garancitë e lidhura me të drejtat e liritë themelore të njeriut për zhvillimin e një gjykimi të kujdesshëm (diligjent) dhe me shpejtësi të çështjeve të kësaj natyre. Lidhur me pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë, ai kolegj ka vlerësuar se janë të pambështetura në ligj e prova, pasi, në thelb, mbështeten tek ushtrimi i vendimmarrjes nga gjyqtari, si edhe drejtimi dhe menaxhimi i procesit gjyqësor (nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve) konform tagrave që i njeh ligji. Në lidhje me themelin e çështjes, Kolegji Penal ka vlerësuar se të gjitha pretendimet që lidhen me ligjshmërinë e autorizimit të dhënë nga Kuvendi janë të pabazuara. Në rastin kur procedohet ndaj një deputeti të Kuvendit, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykata verifikon sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 288, pika 1, të KPP-së, vetëm nëse autorizimi i kërkuar është dhënë ndërsa dhënia apo jo e autorizimit është në diskrecion të Kuvendit dhe ky kontroll i ligjshmërisë së dhënies së autorizimit nga Kuvendi dhe më tej marrja dhe lejimi i provave lidhur me një pretendim të tillë dalin jashtë juridiksionit gjyqësor, kjo për arsye se kompetenca për heqjen e imunitetit në çështjet penale është e vetë parlamentit (neni 73 i Kushtetutës).

11. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet e tjera të kërkuesit kanë marrë përgjigje të argumentuara nga gjykatat më të ulëta. Sipas tij, pjesa e pretendimeve që lidhet me vlerësimin e rrethanave të faktit del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, por, megjithatë, ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenet 231 dhe 260 të KPP-së, për zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është arsyetuar dhe vlerësuar drejt nga të dyja gjykatat, të cilat kanë verifikuar shkeljen e detyrimeve që burojnë nga masa e sigurimit personal në fuqi në raport me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes së kryer (pranuar të tillë nga të dyja gjykatat). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, masa e sigurimit është zëvendësuar *in peius* ndaj kërkuesit në zbatim të neneve 231 dhe 260, pika 3, të KPP-së, për shkak se ai ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij dhe jo për shkak se nevojat e sigurimit janë rënduar. Kolegji Penal, në vlerësimin e tij, ka arsyetuar se gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë vijimësinë e nevojave të sigurimit të evidentuara në gjenezë të caktimit të masës së sigurimit personal, sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së dhe arsyen e zëvendësimit të llojit të masës së sigurimit personal, për shkakun e evidentuar qartësisht në arsyetimin e vendimmarrjes së tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal ka vlerësuar se të dyja gjykatat kanë analizuar dhe evidentuar vijimësinë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm që kërkuesi ka kryer një vepër penale, kusht ky *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të një mase sigurimi personale. Sipas atij kolegji, gjykatat më të ulëta kanë vlerësuar aktuale nevojat e sigurimit, duke evidentuar "shmangien e dëmtimit të hetimeve" dhe "ikjen e kërkuesit" (dy rreziqe të evidentuara që në gjenezë), si dhe kanë arsyetuar përshtatshmërinë e llojit të masës shtrënguese "Arresti në shtëpi" me nevojat e sigurimit sipas rrethanave të rastit konkret. Kolegji Penal ka arsyetuar edhe në lidhje me ndalimet e urdhëruara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për të mos komunikuar me persona të tjerë veç atyre që bashkëjetojnë me të në banesë, të cilat, sipas atij kolegji, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimmarrjes objekt rekursi.

12. Procesi gjyqësor në të cilin janë vendosur masat e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", është bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin e saj nr. 81, datë 21.11.2024, (*vendimi nr. 81/2024*), ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës, duke shfuqizuar këto vendime gjyqësore vetëm për pjesën që kanë caktuar masën "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", për shkak të cenimit të parimit të proporcionalitetit, në aspektin e domosdoshmërisë së kësaj mase, në kushtet kur qëllimet e saj përmbushen nga masa tjetër e dhënë ndaj kërkuesit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore".

13. Ndërkohë, në datën 18.11.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore që kanë zëvendësuar masat e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" me masën "Arresti në shtëpi". Ky ankim kushtetues është regjistruar në datën 18.11.2024.

14. Në datën 26.11.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

15. Gjithashtu, rezulton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 674, datë 27.11.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit dhe revokimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arresti në shtëpi", për shkak se nuk ekzistojnë më nevojat e sigurimit. Në vijim, për ankimin e Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Apelit, në datën 3.1.2025, ka vendosur ndryshimin e vendimit të lartpërmendur të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" me masën e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore".

16. Në datën 25.11.2024, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë një kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, e cila u pranua nga Gjykata.

17. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në datën 3.12.2024 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e një gjyqtari nga shqyrtimi i çështjes, e cila është plotësuar me argumente shtesë në datën 13.1.2025. Po ashtu, i njëjti gjyqtar, në datën 10.1.2025 ka paraqitur

kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimet nr. 30, datë 14.1.2025 dhe nr. 1, datë 14.1.2025, me shumicë votash[1], ka vendosur rrëzimin e kërkesave.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

18. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se procesi gjyqësor i kundërshtuar ka cenuar:

18.1 *Procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit,* të parashikuar nga neni 73 i Kushtetutës, për shkak se procedura e ndjekur në Kuvend për dhënien e autorizimit është bërë në kundërshtim me këtë dispozitë, pasi nuk është ndjekur procedura e parashikuar nga Kushtetuta për kufizimin e lirisë së deputetit në caktimin e masës së sigurimit që pretendohet se nuk është zbatuar nga kërkuesi. Masa e sigurimit ndaj kërkuesit është dhënë bazuar në informacione të pasakta dhe në mungesë të informacionit për ekzistencën e faktit penal, si edhe për veprimtari që mbrohen nga imuniteti absolut i deputetit, i parashikuar nga neni 73 i Kushtetutës. Kërkuesi ka kundërshtuar procedurën e shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit në Kuvend, por gjykatat nuk i kanë shqyrtuar pretendimet e tij me arsyetimin se nuk mund të përbëjnë objekt vlerësimi gjyqësor. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje kërkuesit për ligjshmërinë e procedurës së ndjekur për dhënien e masës së arrestit në shtëpi. Ishte detyrë e gjykatave të verifikonin nëse procedura e ndjekur nga Kuvendi për dhënien e masave të sigurimit ishte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Ndërkohë, sipas kërkuesit, procedura për dhënien e autorizimit duhet të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor. Procedura e ndjekur nga Kuvendi është në shkelje të neneve 288 dhe 289 të KPP-së, pasi Kuvendi nuk ka verifikuar ekzistencën e faktit penal. Autorizimi për heqjen e lirisë së kërkuesit është dhënë bazuar në informacione të paplota, gjysmë të vërteta, në lidhje me detyrimet e masës së sigurimit që është pretenduar se nuk është përmbushur. Procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ka qenë e paragjykuar politikisht, nisur nga deklarimet në Këshillin për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin të deputetëve B.Ç., L.N., E.F. dhe E.A. Po ashtu, në këtë procedurë nuk janë shqyrtuar të gjitha provat, pasi ato nuk janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, por është bërë vetëm duke shqyrtuar vendimet gjyqësore që kishin caktuar më parë masat e sigurimit personal ndaj tij dhe procesverbalet e Policisë Gjyqësore. Pra, në procedurën e zhvilluar në Kuvend nuk ka pasur akte provuese mbi bazën e të cilave mbështetet konkluzioni për ekzistencën e faktit penal në ngarkim të tij dhe nuk është verifikuar nga Kuvendi ekzistenca e këtij fakti penal.

---

[1] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi votuan për pranimin e kërkesës së kërkuesit për përjashtim, sikundër edhe pranimin e kërkesës për heqje dorë të gjyqtares, bazuar në nenin 36, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 8577/2000. Në arritjen e këtij përfundimi u mor në konsideratë shkaku i pretenduar nga kërkuesi, që është marrëdhënia e veçantë mes gjyqtares dhe deputetit E.A., i cili, si anëtar i Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit ka qenë i vetmi deputet i pakicës parlamentare dhe në raportin e hartuar prej tij është shprehur në favor të dhënies së autorizimit. Prania dhe vota e këtij deputeti në Këshill ka qenë përcaktuese për arritjen e kuorumit të vlefshëm për shqyrtimin e kërkesës në këtë Këshill, në përfundim të të cilit i është rekomanduar seancës plenare dhënia e autorizimit për caktimin e masës së arrestit në shtëpi ndaj kërkuesit. Nga ana tjetër, gjyqtarja, si në kërkesën e saj për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, ashtu edhe e dëgjuar nga trupa gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave, nuk e mohoi ekzistencën e marrëdhënies së veçantë të pretenduar nga kërkuesi, ndërkohë që është shprehur se ajo ka paraqitur dorëheqjen, me qëllim ruajtjen e reputacionit të Gjykatës, perceptimit publik për paanshmërinë e saj dhe veçanërisht për të siguruar kërkuesin që procesi do të jetë i drejtë dhe i paanshëm. Në këto kushte, duke pasur parasysh që objekti dhe shkaqet e çështjes në shqyrtim nga Gjykata lidhen me kundërshtimin edhe të akteve të nënshkruara nga ky deputet ashtu edhe të pjesëmarrjes dhe ndikimit të tij në procedurën parlamentare të zhvilluar nga Këshilli, u konsiderua se shkaqet e parashtruara nga kërkuesi janë të tilla që justifikojnë pranimin e kërkesave për përjashtim dhe për heqje dorë, me qëllim garantimin e perceptimit publik dhe eliminimin e çdo dyshimi, qoftë edhe në dukje, për njëanshmërinë e kësaj Gjykate.

18.2. Parimet e *paanshmërisë dhe pavarësisë,* pasi sipas neneve 42 dhe 48-51 të ligjit nr. 95/2016, datë 6.10.2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" (*ligji nr. 95/2016*), gjyqtarët e gjykatave të posaçme janë nën vëzhgimin e një oficeri hetues. Ky vëzhgim mbulon të gjitha komunikimet elektronike dhe të tjera të gjyqtarëve, përfshirë edhe ato të familjarëve të tyre, dhe është i pakufizuar në kohë e hapësirë, si edhe nuk miratohet *a priori* ose kontrollohet *a posteriori* nga ndonjë gjykatë në lidhje me proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje. Në këtë kuptim, gjyqtarët e gjykatave të posaçme janë objekt i një monitorimi që nuk paraqet asnjë garanci ligjore dhe institucionale. Një vëzhgim i tillë i vazhdueshëm ngre dyshime serioze për pavarësinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve të gjykatave të posaçme. Nuk është e mundur që një gjyqtar që gjendet nën një vëzhgim të tillë nga një hetues anonim, sipas nenit 42 të ligjit nr. 95/2016, të jetë një autoritet gjyqësor që plotëson kushtet e pavarësisë. Për më tepër, hetuesi i komunikimeve është pjesë e Byrosë Kombëtarë të Hetimit (*BKH*), e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e kërkuesit dhe i mbron ato përpara gjykatave. Ky ligj cenon procesin e rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, sepse nuk garanton pavarësinë e gjyqtarëve. Gjithashtu, është cenuar edhe parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi gjyqtarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë I.GJ., që ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është shkarkuar nga detyra e gjyqtares nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (*ish-KLD*) në vitin 1996, kohë kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi në cilësinë e Presidentit të Republikës. Kjo kërkesë është paraqitur edhe në GJKKO-në e Shkallës së Parë, ku gjyqtarja për të cilën është paraqitur kërkesa për përjashtim ka caktuar edhe gjyqtaren tjetër që do të shqyrtonte këtë kërkesë për përjashtim, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm. Si përfundim, kërkesa për përjashtim nuk është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023.

18.3 *Të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi vendimet e gjykatave përmbajnë të dhëna kontradiktore dhe nuk u kanë dhënë zgjidhje të plotë dhe shteruese pretendimeve të ngritura. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje kërkuesit për pretendimin e tij për mbikëqyrjen e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme nga Prokuroria e Posaçme. Arsyetimi i gjykatave në lidhje me procedurat për përjashtimin e gjyqtares është telegrafik. GJKKO-ja e Apelit nuk ka arsyetuar përse ka refuzuar marrjen e provave të kërkuesit. Arsyetimi arbitrar i GJKKO-së së Apelit nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë, e cila nuk është shprehur as për cenimin e parimit të pavarësisë për shkak të dispozitave të ligjit nr. 95/2016. Gjykatat nuk kanë arsyetuar pretendimin e kërkuesit në lidhje me mosekzistencën e kushtit procedural "Shkelja e detyrimeve që lidhen me një masë tjetër sigurimi", të parashikuar nga neni 231 i KPP-së, duke qenë se vendimet me të cilat janë caktuar masat e sigurimit nuk i janë njoftuar atij.

18.4 Kërkuesi ka ngritur pretendime edhe në drejtim të *së drejtës për mbrojtje efektive, të lidhur me parimin e barazisë së armëve,* duke argumentuar se GJKKO-ja e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim vendimin e saj nr. 23, datë 5.1.2024 (vendimi për papranueshmërinë e kërkesës për përjashtim), të kërkuar prej tij. GJKKO-ja e Apelit nuk ka dhënë asnjë arsyetim në vendimin e saj të ndërmjetëm për mosmarrjen e kësaj prove. Kjo provë ishte e rëndësishme, pasi provonte që kërkesa për përjashtimin e gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë me një vendim të formës së prerë, është konsideruar e paraqitur brenda afatit dhe nuk është shqyrtuar për shkak se gjyqtarja për të cilën kërkohej përjashtimi kishte shpallur vendimin përfundimtar.

18.5 *Parimin e sigurisë juridike,* për shkak të mungesës së qartësisë dhe qëndrueshmërisë në interpretimin e dispozitave procedurale penale në zbatimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse. Nga interpretimi i neneve 246 dhe 417 të KPP-së, rezulton se vendimet të cilat kufizojnë lirinë personale të individit nuk janë menjëherë të ekzekutueshme, por ekzekutimi i tyre pezullohet nga ankimi. Për shkak të paqartësisë në lidhje me momentin e lindjes së detyrimit për zbatimin e masave të sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit me vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, që është pretenduar se nuk janë zbatuar nga kërkuesi dhe që më tej janë bërë shkak për kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit, si edhe nga zbatimi dhe

interpretimi i ndryshëm i kufizimit të së drejtës personale të kërkuesit nga autoritetet shtetërore, cenimi i lirisë së kërkuesit me vendimet objekt të këtij ankimi kushtetues, nuk e plotëson kushtin e procedurave të parashikuara në ligj, në aspektin e qartësisë së këtyre procedurave.

18.6 *Lirinë personale,* për shkak se nuk është respektuar procedura e parashikuar në ligj në lidhje me mosekzistencën e shkakut procedural për të cilin është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit, pasi vendimi gjyqësor mbi bazën e të cilit ishin caktuar masat e sigurimit personal nuk ka qenë i ekzekutueshëm deri në datën 21.11.2023 kur ka marrë formë të prerë. Shkaku për të cilin është zëvendësuar masa e sigurimit nuk ka ekzistuar, pasi nuk janë respektuar dispozitat që rregullojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Edhe pse masat e sigurimit për kërkuesin janë dhënë nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe gjykatat kanë pranuar argumentet e Prokurorisë së Posaçme se ai nuk është paraqitur në Policinë Gjyqësore, ato (gjykatat) nuk kanë hetuar kur ka lindur detyrimi i kërkuesit për t'i zbatuar ato masa sigurimi të caktuara me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Arsyetimi i gjykatave se detyrimi për zbatimin e masave të sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit"* ka lindur menjëherë me shpalljen e vendimit, është i gabuar dhe në kundërshtim me nenin 417 të KPP-së. Pra, zbatimi i masave të sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit"* ka qenë arbitrar, pasi detyrimi për zbatim për kërkuesin lindte pasi të shqyrtohej ankimi nga GJKKO-ja e Apelit. Pas marrjes formë të prerë të vendimit nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, Prokuroria e Posaçme nuk ka nxjerrë urdhër, për pasojë vendimi nuk është vënë asnjëherë në ekzekutim dhe për kërkuesin nuk ka lindur asnjë detyrim. Procedura e caktimit të masave të sigurimit të vendosura ndaj kërkuesit ka qenë e paligjshme, për rrjedhojë edhe zëvendësimi i masës për shkak të moszbatimit të njërës prej masave të sigurimit të vendosura me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë është e paligjshme.

18.7 *Parimin e proporcionalitetit,* duke i kufizuar edhe të drejta të tjera të parashikuara nga Kushtetuta, siç janë liria personale, e drejta për jetë familjare, liria e shprehjes, liria e organizimit, e drejta për të ushtruar mandatin parlamentar, për shkak se kufizimi i tyre është bërë pa ligj. Këto kufizime nuk janë të nevojshme, pasi fakti penal i dyshuar, për të cilin është duke u kryer hetimi, nuk ka lidhje me ushtrimin nga kërkuesi të të drejtave që janë kufizuar nga gjykatat. Kufizimi nuk është proporcional. Gjykatat nuk kanë arsyetuar përse nevojat e sigurimit nuk garantoheshin me masa më të lehta sigurimi, siç janë "Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar" dhe "Garancia pasurore". Gjykatat nuk mund të përcaktojnë kufizime tej atyre të përcaktuara nga ligji. Ato i kanë kufizuar kërkuesit të drejtat politike dhe të lirisë së shprehjes, pavarësisht se në ushtrim të tyre nuk ka kryer ndonjë fakt të pretenduar penal dhe nuk është duke u hetuar për ndonjë fakt penal që ka lidhje me këto të drejta dhe liri. Në vendimet e ankimuara mungon tërësisht arsyetimi. Masa e sigurimit është caktuar në mungesë të faktit penal. Fakti për të cilin është regjistruar procedimi penal nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor, pasi është veprimtari politike që rrjedh nga funksioni i deputetit.

18.8 *Parimin e mosdiskriminimit,* për shkak se kërkuesi është kryetari i partisë opozitare me numrin më të lartë të deputetëve në Kuvend. Kryeministri i vendit është shprehur në kongresin e Partisë Socialiste se reforma në drejtësi ka dështuar në rast se Prokuroria e Posaçme nuk heton kërkuesin.

19. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

19.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimeve të *pavarësisë dhe paanshmërisë*, për shkak të përcaktimeve të neneve 49-51 të ligjit nr. 95/2016, është i pabazuar, pasi ky i fundit parashikon një mjet mbikëqyrës për GJKKO-të, Prokurorinë e Posaçme dhe BKH-në, si një masë parandaluese kundër korrupsionit në këto institucione, por pa cenuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të hetuesve. Sistemi i kontrollit i parashikuar në ato dispozita është i garantuar nga një procedurë strikte. Ligji nr. 95/2016 ka vendosur garanci të rëndësishme gjatë procesit të monitorimit, ku oficerit përgjegjës nuk i lejohet të dëgjojë telefonatat që shkelin të drejtën për jetë

private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin. Parashikimet e dispozitave të kundërshtuara nga kërkuesi janë parashikuar shprehimisht në nenin 135, pika 4, të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata vendoset para faktit që duhet të shqyrtojë vetë dispozitën kushtetuese, ndërkohë që sipas nenit 131, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

19.2 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës *së mbrojtjes efektive* është i pabazuar, pasi ai gjatë gjithë kohës që ka qenë në masën e sigurimit "Arresti në shtëpi" ka komunikuar vazhdimisht me mbrojtësit e tij. Kjo konfirmohet edhe nga ankimet e bëra prej tij ndaj vendimit të caktimit të masës së sigurimit në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor, përfshirë edhe ankimin në këtë Gjykatë.

19.3 Pretendimi për antikushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi për *heqjen e imunitetit* është i pabazuar. Në lidhje me këtë pretendim edhe gjykatat e kanë dhënë përgjigjen e tyre në vendimet që kanë shqyrtuar ankimet e kërkuesit kundër vendimit që ka vendosur masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", ku thelbi i tyre ishte se procedura e dhënies së autorizimit nga Kuvendi nuk është objekt i vlerësimit gjyqësor.

19.4 Pretendimi i kërkuesit se nuk është zbatuar procedura e parashikuar në ligj për zëvendësimin e masës së sigurimit, pasi shkaku për të cilin është zëvendësuar ajo nuk ka ekzistuar, është i pabazuar. Sipas akteve konstatohet se edhe pse kërkuesi ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të mos u njohur me vendimin nr. 112/2023, në fakt, rezulton se ai është njohur me atë vendim, i cili u është vënë në dispozicion edhe mbrojtësve të kërkuesit, duke qenë se ata gëzonin tagrin për të marrë në dorëzim akte për llogari të tij Gjithashtu, referuar të gjitha të dhënave të publikuara nga mediat, rezulton se kërkuesi është njohur me disponimin e vendimit nr. 112/2023, që ka caktuar masat e sigurimit personal të vendosura ndaj tij. Në këtë kuptim, rezulton se ka qenë vetë kërkuesi që ka refuzuar të marrë në dorëzim atë vendim, megjithëse ai është njohur me përmbajtjen e tij.

19.5 Pretendimi i kërkuesit se masa e sigurimit është caktuar në mungesë të faktit penal është i pabazuar, pasi fakti penal është konfirmuar nga të dyja gjykatat në mënyrë të plotë dhe të qartë. Ky fakt penal është konsoliduar në vijim dhe çështja penale në ngarkim të tij është në fazën e gjykimit.

19.6 Pretendimi i kërkuesit se gjykatat nuk kanë argumentuar nevojshmërinë e masës së sigurimit personal, duke i cenuar edhe lirinë e shprehjes, të drejtat politike dhe lirinë e organizimit, është i pabazuar. Referuar vendimeve të gjykatave rezulton se ato kanë bërë një analizë tërësore të rezultateve të hetimit dhe në këtë mënyrë kanë konkluduar me vendimmarrje në përputhje me dispozitat përkatëse. Ato vendime nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore, të paqarta ose në mungesë të elementeve formale. Edhe pse me masë sigurimi "Arresti në shtëpi", kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të shprehjes, lirinë politike dhe atë të organizimit. Kushtet dhe kriteret në caktimin e masave të sigurimit janë analizuar qartësisht nga gjykatat.

20. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim përpara Gjykatës, duke mos mbajtur një qëndrim në lidhje me çështjen, por ka paraqitur kopje të akteve të procedurës parlamentare të ndjekur në rastin konkret për dhënien e autorizimit për zëvendësimin e masës së sigurimit të caktuar ndaj kërkuesit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

21. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të

ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

22. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae,* Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit që kanë vendosur ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", për shkak të mospërmbushjes të masës së sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" të caktuar ndaj tij me vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Këto të fundit (vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023) kanë caktuar ndaj kërkuesit edhe masën tjetër të sigurimit personal "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", por duke qenë se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" është zëvendësuar për shkak se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimin e masës së sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", Gjykata do t'u referohet atyre vendimeve vetëm për këtë masë sigurimi.

23. Gjykata vëren, gjithashtu, se me vendimin e datës 27.11.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e kërkuesit dhe ka revokuar masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arresti në shtëpi", ndërsa GJKKO-ja e Apelit, me vendimin e datës 3.1.2025, ka ndryshuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore". Në kushtet kur vendimi gjyqësor objekt ankimi nuk prodhon më efekte për kërkuesin, Gjykata do të vlerësojë, së pari, nëse ai (kërkuesi) mbart ende statusin e "viktimës" që do ta legjitimonte për të paraqitur një ankim para kësaj Gjykate. Për këtë qëllim, Gjykata sjell në vëmendje interpretimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas të cilit fjala "viktimë", sipas kontekstit të nenit 34 të KEDNJ-së, përcakton personin që preket drejtpërdrejt nga veprimi ose mosveprimi konkret. Sipas GJEDNJ-së, një vendim ose masë (e mëvonshme) në favor të kërkuesit, në parim, nuk është e mjaftueshme për ta privuar atë nga statusi i tij si "viktimë", nëse autoritetet vendase nuk kanë pranuar, shprehimisht ose në thelb, duke korrigjuar më pas shkeljen konkrete të Konventës (*shih Afërdita Hysa kundër Shqipërisë, datë 21 shkurt 2023, § 52*).

24. Për këtë arsye, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, duke pasur parasysh se masa e sigurimit me heqje lirie ndaj kërkuesit (vendimi gjyqësor objekt ankimi) nuk u pranua për shkak të konstatimit të paligjshmërisë së saj, por si rezultat i ndryshimit të nevojave të sigurimit, kërkuesi e ruan statusin e viktimës dhe, për pasojë, legjitimohet *ratione personae* si në aspektin procedural, ashtu edhe atë substancial, pasi jo vetëm ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, por provon edhe interesin e drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues. Në vlerësimin e Gjykatës, pavarësisht se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" është zëvendësuar nga gjykatat me një masë më të lehtë, konkretisht me masën "Detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, dhe ai proces është ende në pritje të gjykimit nga Gjykata e Lartë, kërkuesi e mbart ende statusin e viktimës, pasi gjykatat e zakonshme nuk e kanë njohur/korrigjuar shkeljen e së drejtës që pretendohet se është shkelur.

25. Po ashtu, Gjykata evidenton se edhe ndryshimet e vazhdueshme të masës së sigurimit në ngarkim të kërkuesit nuk mund të konsiderohen si korrigjim, duke qenë se kërkesat për ndryshimin e masës së sigurimit mund të bëhen nga i dyshuari në çdo kohë dhe fati i tyre (pranimi ose jo nga gjykata) përcaktohet ekskluzivisht nga ndryshimi i nevojave të sigurimit, për pasojë vendimet gjyqësore që ndryshojnë masat e sigurimit *in melius* nuk mund të konsiderohen si korrigjime të shkeljes së pretenduar. Thënë ndryshe, pavarësisht se masa e sigurimit e kundërshtuar nga kërkuesi "Arresti në shtëpi" nuk është më në fuqi për shkak të revokimit e, më pas, ndryshimit të saj dhe, për rrjedhojë, vendimet objekt kërkese nuk sjellin më pasoja ndaj tij, kjo nuk ndryshon faktin se

kërkuesi ka qenë duke vuajtur një masë heqjeje të lirisë, për të cilën ai pretendon se është jokushtetuese dhe në kundërshtim me liritë dhe të drejtat e tij.

26. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendimet gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi", duke qenë se ato lidhen me heqjen e lirisë së individit dhe konsiderohen përfundimtare për qëllime të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 13, datë 13.3.2024; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Po për sa i përket plotësimit të kriterit të shterimit, Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 3, datë 11.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuesi i ka shteruar formalisht të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm.

28. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se ky kriter kërkon që pretendimet që parashtrohen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket plotësimit të këtij kriteri në drejtim të pretendimeve të paraqitura, Gjykata vëren se pretendimet e ngritura nga kërkuesi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, për shkak të mungesës së qartësisë dhe qëndrueshmërisë në interpretimin e neneve 246 dhe 417 të KPP-së, nga ku nuk rezulton e qartë nëse vendimet që kufizojnë lirinë personale të individit me masa sigurimi personal pezullohen ose jo nga ankimi i paraqitur në gjykatën e apelit; për cenimin e *lirisë personale*, për shkak se përmbushja e detyrimit të masës të sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij ka lindur vetëm pasi vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka disponuar për të është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit; për cenimin e *parimit të mosdiskriminimit,* për shkak se Kryeministri i vendit është shprehur në kongresin e Partisë Socialiste se reforma në drejtësi ka dështuar në rast se Prokuroria e Posaçme nuk heton kërkuesin, ky i fundit nuk i ka ngritur as në ankimin e drejtuar GJKKO-së së Apelit, as në rekursin e tij drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Gjykata çmon se lidhur me këto pretendime dhe argumente ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

29. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkuesi, rezulton që ai t'i ketë parashtruar ato në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme dhe në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, konsiderohet se ai i ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

30. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i datës 9.4.2024, u është komunikuar mbrojtësve të kërkuesit në adresat e tyre të postës elektronike në datën 29.9.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 18.11.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

31. Në lidhje me kriterin e legjitimimit *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, ai verifikohet në drejtim të përmbajtjes dhe natyrës së pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual. Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *parimit të pavarësisë* së gjyqtarëve të GJKKO-së për shkak të përmbajtjes së dispozitave të ligjit nr. 95/2016, të cilat përcaktojnë kontrollin periodik të telekomunikimeve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe familjarëve të tyre të afërt nga BKH-

ja. Po ashtu, në pretendimin e tij për cenimin e së *drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit*, kërkuesi ka argumentuar se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje për pretendimin për efektet e regjimit të vëzhgimit për pavarësinë e gjyqtarëve të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas kërkuesit, vendimi nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë, që ka vendosur masën e sigurimit personal, e cila pretendohet nga Prokuroria e Posaçme se nuk është zbatuar prej tij, nuk i është njoftuar. Gjykata konstaton, gjithashtu, se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *imunitetit parlamentar*, duke argumentuar, ndër të tjera, se procedura e ndjekur në Kuvend për dhënien e autorizimit është bërë në kundërshtim me nenin 73 të Kushtetutës, për shkak se nuk është ndjekur procedura e parashikuar nga Kushtetuta për kufizimin e lirisë së deputetit në caktimin e masës së sigurimit që pretendohet se nuk është zbatuar prej tij.

32. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vëren se në vendimin e saj nr. 81/2024, ajo ka marrë në shqyrtim edhe përmbajtjen e neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016, duke vlerësuar se ato nuk cenojnë parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë në gjykim dhe se ligji përmban garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve në mënyrën se si realizohet kontrolli (*shih paragrafët 65-77*). Po ashtu, në vendimin e saj nr. 81/2024, Gjykata ka vlerësuar se argumenti i kërkuesit, sipas të cilit Kuvendi duhet të japë autorizimin në rastin e caktimit të masave të detyrimit për paraqitje në Policinë Gjyqësore dhe të ndalimit të daljes jashtë shtetit, nuk pajtohet me parashikimin e nenit 73 të Kushtetutës dhe autorizimi i Kuvendit është i nevojshëm vetëm nëse masat kufizuese të vendosura ndaj kërkuesit përbëjnë kufizim/heqje të lirisë së tij personale (*shih paragrafët 58-59*)[2]. Në vlerësimin e saj, me vendimin nr. 81/2024, Gjykata ka evidentuar se nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë janë marrë të gjitha masat për njoftimin kërkuesit të vendimit nr. 112/2023, i cili ka disponuar për masat e sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit dhe pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë të bazuara (*shih paragrafin 87*).

33. Në këtë kuptim, Gjykata ripohon se kur ajo është shprehur më parë me vendim përfundimtar për themelin e pretendimeve të ngritura nga palët, ai vendim përbën pengesë për Gjykatën që të rimarrë përsëri në shqyrtim të njëjtat pretendime, të ngritura për të njëjtat shkaqe (*shih vendimin nr. 60, datë 28.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, duke pasur parasysh se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve të posaçëm, si rrjedhojë e parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 95/2016, cenimit të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit, pasi gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje atij lidhur me pretendimin për efektet e regjimit të vëzhgimit për pavarësinë e gjyqtarëve të GJKKO-së së Shkallës së Parë, që lidhen përsëri me dispozitat e ligjit nr. 95/2016, si edhe mosnjoftimit të vendimit nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë, dhe imunitetit parlamentar, për shkak se nuk është ndjekur nga Kuvendi procedura e parashikuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës për dhënien e autorizimit për heqjen e lirisë së deputetit, i janë nënshtruar tashmë vlerësimit kushtetues dhe janë bërë objekt i një vendimmarrjeje të mëparshme kushtetuese me vendimin nr. 81/2024, duke u gjendur të pabazuara, Gjykata çmon se ato nuk mund të merren në shqyrtim.

34. Për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuesi ka argumentuar se caktimi i masës së sigurimit "Arresti në shtëpi", pavarësisht se ajo ka ardhur si pasojë e mospërmbushjes së masave të caktuara me vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duhet të respektojë edhe kriteret e tjera të parashikuara në nenin 27 të Kushtetutës dhe dispozitat përkatëse procedurale penale. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuesit lidhen me pasojat që ka sjellë zëvendësimi i masave të sigurimit në ushtrimin prej tij të të drejtave dhe lirive të tjera kushtetuese, siç janë liria personale, e drejta për jetë familjare, liria e shprehjes, liria e organizimit dhe e drejta për të ushtruar mandatin parlamentar. Sipas kërkuesit, këto kufizime nuk janë të nevojshme, pasi fakti penal i dyshuar, për të cilin është duke u kryer hetimi penal, nuk ka lidhje me ushtrimin prej tij të të drejtave dhe lirive që janë kufizuar nga gjykatat dhe kufizimi nuk është proporcional. Po

[2] Në vendimin nr. 81/2024 gjyqtarja në pakicë Sonila Bejtja ka mbajtur qasjen e saj se duhej të ishte marrë autorizimi nga Kuvendi për lejimin e caktimit ndaj kërkuesit të masës së sigurimit "Ndalimi i daljes jashtë shtetit".

sipas kërkuesit, gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar se përse nevojat e sigurimit në rastin konkret nuk garantoheshin me masa më të lehta sigurimi, siç janë "Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar" apo "Garancia pasurore". Në aspektin procedural, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e garancive që ofron e drejta për proces të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, në drejtim të parimit të paanshmërisë, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë nga ish-KLD-ja në kohën që drejtohej nga kërkuesi në cilësinë e Presidentit të Republikës, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, së drejtës për mbrojtje efektive të lidhur me parimin e barazisë së armëve, si edhe imunitetit parlamentar.

35. Gjykata, fillimisht, evidenton se masa e sigurimit e caktuar ndaj kërkuesit është "Arresti në shtëpi". Gjithashtu, Gjykata vëren se me anë të kësaj mase, kërkuesi është urdhëruar të mos largohet nga banesa, si edhe të mos komunikojë me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të, detyrime të cilat kanë intensitet të tillë që mund të barazohen me heqjen e lirisë. Në këtë këndvështrim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se neni 27 i Kushtetutës garanton lirinë personale dhe funksionin e deputetit që ushtron kërkuesi, si edhe thelbin e argumenteve të tij për kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, vlerëson t'i shqyrtojë ato nën prizmin e lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës dhe së drejtës substanciale për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues të deputetit nga kërkuesi, të mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të masës së sigurimit "Arresti në shtëpi".

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e lirisë personale

36. Gjykata ka pohuar se ndërkohë që aspekti substancial i lirisë personale mbrohet nga neni 27 i Kushtetutës, për aspektin procedural të kësaj lirie ajo ka theksuar se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura. Po sipas Gjykatës, garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, gjejnë zbatim edhe në proceset gjyqësore që vendosin për kufizimin e lirisë personale (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 19, datë 4.4.2023*), sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi të lidhura me garancitë e parashikuara nga neni 28 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, procedura e parashikuar nga paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ-së, kur është rasti, duhet të plotësojë të njëjtat garanci si ato të kërkuara në nenin 6 § 1 të Konventës për çështjet penale ose civile dhe ajo duhet të ketë karakter gjyqësor dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për llojin e heqjes së lirisë në fjalë (*shih vendimin nr. 83, datë 5.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Lidhur me kufizimin e lirisë personale, Gjykata vëren se sipas nenit 27, pika 2, shkronja "b", të Kushtetutës, liria e personit mund të kufizohet edhe për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës. Kurse sipas nenit 5, pika 4, të KEDNJ-së çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë, me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

38. Nga ana tjetër, sipas nenit 42 të Kushtetutës, liria dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

39. Bazuar në sa më lart, Gjykata vlerëson se aspekti substancial i lirisë personale duhet analizuar nën dritën e nenit 27 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 83, datë 5.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), ndërsa aspekti procedural i saj nën atë të nenit 28 të saj të lidhur me nenin 42.

40. Po kështu, duke qenë se kërkuesi gëzon statusin e deputetit dhe procesi gjyqësor për zëvendësimin e masës së sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" me masën "Arresti në shtëpi" paraprihet nga procesi që zhvillon Kuvendi, sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, për dhënien e autorizimit për caktimin e masës "Arresti në shtëpi", Gjykata në vijim do të verifikojë në aspektin procedural si procedurën e zhvilluar nga Kuvendi, ashtu edhe procedurën e zhvilluar nga gjykatat.

41. Në këtë kuptim, Gjykata, duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuesit, në vijim do të shqyrtojë aspektet procedurale që kanë të bëjnë me: *i)* procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit; *ii)* të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit; *iii)* parimin e paanshmërisë në kuadër të ankimeve të bëra gjatë procesit gjyqësor, për shkak të lirimit të gjyqtares I.Gj. nga detyra nga ish-KLD-ja dhe për shkak të mosmarrjes në shqyrtim nga GJKKO-ja e Apelit të pretendimit të kërkuesit për paraqitjen e kërkesës së dytë për përjashtimin e asaj gjyqtareje, si aspekte procedurale të të drejtave substanciale të sipërpërmendura; *iv)* aspektin substancial të kufizimit të këtyre të drejtave në drejtim të parimit të proporcionalitetit të masës së sigurimit të vendosur për kërkuesin.

B.1.1 Për aspektet procedurale të cenimit të lirisë personale

B.1.1.1 Për cenimin e procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit

42. Kërkuesi ka pretenduar se procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ka qenë paragjykuar politikisht, nisur nga deklarimet e bëra në Kuvend në mbledhjen e Këshillit nga deputetët të B.Ç., L.N., E.F. dhe E.A. Sipas kërkuesit, procedura e zhvilluar në Kuvend ka qenë e paragjykuar politikisht, nisur nga dhënia e opinionit në lidhje me kërkesën e deputetit B.Ç. dhe opinionet e anëtarëve të tjerë të Këshillit. Në vlerësimin e kërkuesit, në procedurën e zhvilluar në Kuvend nga Këshilli nuk janë shqyrtuar të gjitha provat, pasi ato nuk janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, por janë shqyrtuar vetëm vendimet gjyqësore që kishin caktuar më parë masat e sigurimit personal ndaj tij dhe procesverbalet e Policisë Gjyqësore për përmbushjen e atyre masave. Pra, sipas kërkuesit, në procedurën e zhvilluar në Kuvend nuk ka pasur akte provuese mbi bazën e të cilave mbështetet konkluzioni për ekzistencën e faktit penal në ngarkim të tij dhe nuk është verifikuar nga Kuvendi ekzistenca e këtij fakti penal. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje për ligjshmërinë e procedurës së ndjekur për dhënien e masës së arrestit në shtëpi. Po sipas kërkuesit, ishte detyrë e gjykatave të verifikonin nëse procedura e ndjekur nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ishte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

43. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar, duke argumentuar, se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar, pasi gjykatat e kanë dhënë përgjigjen e tyre në vendimet që kanë shqyrtuar ankimet e kërkuesit kundër vendimit që ka vendosur masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", ku thelbi i tyre ishte se procedura e dhënies së autorizimit nga Kuvendi nuk ishte objekt i vlerësimit gjyqësor. Sipas Prokurorisë së Posaçme, pretendimi i kërkuesit se masa e sigurimit është caktuar në mungesë të faktit penal është i pabazuar, pasi fakti penal është konfirmuar nga të dyja gjykatat në mënyrë të plotë dhe të qartë dhe se ky fakt penal është konsoliduar në vijim dhe çështja penale në ngarkim të tij është në fazën e gjykimit në themel.

44. Gjykata ka pohuar se regjimi i imuniteteve, në çdo rast, synon, nga njëra anë, të garantojë ushtrimin e qetë dhe të pandikuar të funksioneve të rëndësishme publike nga zyrtarët e lartë të shtetit, të cilët nuk duhet të druhen se veprimtaria e tyre shtetërore mund të bëhet shkas për pasoja personale, si, për shembull, një padi civile ose një akuzë penale. Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, dispozitat që përbëjnë regjimin e imuniteteve synojnë të garantojnë përgjegjshmërinë e këtyre funksionarëve të lartë në qoftë se, në përfundim të verifikimeve përkatëse dhe një procesi të rregullt ligjor, rezulton se veprimet e tyre nuk janë të motivuara nga interesi publik, por nga interesi privat ose keqbesimi (*shih vendimin nr. 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Imuniteti i deputetëve nuk është privilegj personal i tyre, por qëllimi kryesor i tij (imunitetit parlamentar) është mbrojtja e vetë parlamentit dhe në veçanti funksionimi i duhur i tij. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se duhet të ekzistojë një prezumim themelor që imuniteti duhet të

hiqet në të gjitha rastet kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit përkatës janë të motivuara politikisht dhe se paprekshmëria e tij duhet të zbatohet vetëm në rastet kur ka arsye për të dyshuar se në vendimin për ndjekjen penalisht të deputetit ka elemente partiako-politike (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se paprekshmëria penale ndihmon për të arritur pavarësinë e plotë të Parlamentit, duke parandaluar çdo mundësi të procedimeve penale të motivuara politikisht (*fumus persecutionis)* dhe mbron pakicën parlamentare nga presioni ose abuzimi i shumicës parlamentare. Mekanizmi për zbatimin e detyrimit parlamentar, që konsiston në marrjen e një vendimi për të hequr apo jo imunitetin, është një nga mënyrat me të cilat Parlamenti ushtron autonominë e tij (*shih vendimin Kart kundër Turqisë, datë 3 dhjetor 2009, §§96, 101)*

47. Në lidhje me procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit, Komisioni i Venecias ka mbajtur qëndrimin se është e vështirë për Kuvendin (komisionin parlamentar përkatës) të vlerësojë heqjen e imunitetit pa u futur në detajet dhe themelin e akuzave penale të rastit specifik dhe pa formuar një opinion paraprak. Gjithashtu, sipas Komisionit të Venecias, kjo është në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, sipas të cilit vetëm gjykatat mund të vlerësojnë përgjegjësinë penale individuale. Organi parlamentar që shqyrton kërkesat për heqje imuniteti nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes si të tillë (*shih raportin CDL-AD (2014) 011 të Komisionit të Venecias).*

48. Për sa më lart, referuar edhe pretendimeve të kërkuesit, për të vlerësuar nëse në rastin konkret ka pasur cenim të procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit parlamentar, Gjykata, në vijim, do ta analizojë këtë pretendim, duke u bazuar në aktet e Këshillit (procesverbali dhe raportet), aktet mbi të cilat anëtarët e Këshillit kanë vlerësuar dhënien e autorizimit, si edhe rrethanat e rastit konkret. Në këtë kuptim, Gjykata do ta analizojë nëse procedura e ndjekur nga Kuvendi për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së arrestit ndaj kërkuesit ka qenë e ndikuar politikisht dhe nëse ka qenë e bazuar në prova të mjaftueshme.

49. Në rastin konkret, rezulton se Prokuroria e Posaçme në datën 12.12.2023 i është drejtuar Kuvendit me kërkesë për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit (kërkuesit) nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij, për shkak se kërkuesi nuk kishte zbatuar detyrimet e vendosura më parë ndaj tij, duke paraqitur edhe relacionin shoqërues, si edhe provat ku mbështeste kërkesën e saj. Sipas Prokurorisë së Posaçme, në rastin konkret përmbushen kërkesat e parashikuara nga nenet 231 dhe 260 të KPP-së, pasi personi nën hetim (kërkuesi), në mënyrë të përsëritur, nuk ka zbatuar detyrimet që i janë ngarkuar nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore, për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore. Për këtë arsye, Kuvendi ka nisur procedurën për shqyrtimin e kësaj kërkese të Prokurorisë së Posaçme, duke thirrur mbledhjen e Këshillit në datën 18.12.2023.

50. Referuar procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, si dhe akteve bashkëlidhur kërkesës, rezulton që kërkesa, relacioni dhe provat (procesverbalet e oficerit të Policisë Gjyqësore për paraqitjen e kërkuesit dhe vendimet gjyqësore që kanë vendosur masat e sigurimit personal, të cilat nuk janë zbatuar prej tij) të jenë vënë në dispozicion të anëtarëve të tij. Rezulton, gjithashtu, që mbrojtësit e kërkuesit t'i kenë kërkuar Këshillit pezullimin e procedurës për dhënien e autorizimit nga Kuvendi deri në përfundimin e gjykimit nga Gjykata Kushtetuese të çështjes së paraqitur nga kërkuesi për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. Në lidhje me këtë kërkesë anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje kanë votuar për rrëzimin e saj. Në vijim, anëtarët e Këshillit i kanë drejtuar pyetje prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe mbrojtësve të kërkuesit. Po kështu, rezulton që në mbledhje të kenë shprehur mendimin e tyre në lidhje me kërkesën për dhënien e autorizimit të Kuvendit edhe deputetja E.F., si edhe kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, deputeti B.Ç., i cili ka pohuar se "*ne [...] si grup parlamentar do të votojmë çdo kërkesë për heqje imuniteti [...]*" *(faqe 62)*. Në vlerësimin e këtyre anëtarëve të Këshillit (E.F. dhe B.Ç.) vetë kërkuesi është shprehur që të jetë pa imunitet dhe se ai nuk ka respektuar dhe ka injoruar vendimet e gjykatave, si edhe se në rastin konkret janë rënduar

nevojat e sigurimit, pasi ai ka mobilizuar njerëz duke i sjellë pranë godinave të Kuvendit dhe pretendon t'i sjellë sërish në sallën e seancave plenare për të bllokuar punën e Kuvendit dhe dhënien e autorizimit.

51. Në përfundim të diskutimeve, Këshilli i ka rekomanduar seancës plenare dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit. Megjithatë, për sa kohë që në lidhje me arsyet e dhënies së autorizimit ka pasur mendime të ndryshme ndërmjet anëtarëve të Këshillit, seancës plenare i janë paraqitur dy raporte rekomanduese. Sipas njërit raport (i deputetëve të shumicës anëtarë të Këshillit) kërkesa e paraqitur nga mbrojtësit e kërkuesit për pezullimin e procedurës për dhënien e autorizimit është e pabazuar në ligj, pasi nuk ka asnjë dispozitë ligjore mbi të cilën të mbështetet ajo, si edhe nuk ka asnjë vendim të Gjykatës për pezullimin e kësaj procedure. Sipas këtij raporti, Këshilli nuk mund të marrë në shqyrtim bazueshmërinë në prova dhe fakte të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, pasi do të cenonte parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe se vlerësimin nëse janë ose jo kushtet dhe kriteret për vendosjen e një mase sigurimi personal e kanë gjykatat, bazuar në parashikimet e KPP-së. Po sipas këtij raporti, nga pikëpamja formale kërkesa e Prokurorisë së Posaçme është në përputhje me kërkesat ligjore dhe ai organ legjitimohet ta paraqesë atë në Kuvend. Sipas anëtarëve të shumicës, kërkesa plotëson kriteret e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, pasi bëhet për ato shkaqe që parashikon kjo dispozitë dhe është në përputhje edhe me nenin 228, pikat 1 dhe 2, të KPP-së, duke u shoqëruar me relacionin shpjegues dhe provat përkatëse, sipas kërkesave të kësaj dispozite. Gjithashtu, sipas këtij raporti, gjatë shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, nuk rezulton që ajo të jetë bërë në kushtet e ndikimit politik apo të një natyre/ndërhyrje tjetër të padrejtë që të bjerë ndesh me interesat e drejtësisë.

52. Sipas raportit tjetër rekomandues (i deputetit të pakicës anëtar i Këshillit), nga analiza e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, relacionit shoqërues dhe përgjigjeve të prokurorëve në mbledhjen e Këshillit konstatohet pa asnjë dyshim ekzistenca e procedimit penal ndaj kërkuesit dhe rrjedhimisht arrihet në përfundimin se plotësohet kushti ligjor se ndaj tij ekziston procedimi penal. Gjithashtu, sipas këtij raporti, konstatohet pa asnjë dyshim se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme tregon kushtet ligjore për veprimet e arrestit dhe të kontrollit, në përputhje me nenin 288 të KPP-së dhe evidentohen qartazi kushtet e neneve 228, 229, 230, 231, pika 1 dhe 260, pika 3, të KPP-së, që lidhen me *i)* dyshimet e arsyeshme të bazuara në prova; *ii)* rrezikun përkundrejt procedimit; *iii*) papërshtatshmërinë e masave të tjera. Në vijim, në këtë raport është pohuar se në vlerësimin në themel të çështjes për mbajtjen ose jo të imunitetit, në këtë rast vërehen lehtësisht plotësimet e kritereve në favor të dhënies së autorizimit, duke u renditur edhe arsyet për këtë pohim.

53. Në rastin konkret, në lidhje me argumentin e kërkuesit se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje për pretendimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur nga Kuvendi për dhënien e autorizimit, Gjykata vëren se sipas gjykatave, GJKKO-së së Apelit dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pretendimet e ngritura nga kërkuesi se gjykata e shkallës së parë duhet të kontrollonte ligjshmërinë e autorizimit të dhënë nga Kuvendi, del jashtë juridiksionit gjyqësor dhe posaçërisht atij penal, respektimi i të cilit është thelbësor për të garantuar paanshmërinë dhe drejtësinë e gjykimit. Po sipas atyre gjykatave, në të kundërt me sa pretendon kërkuesi, në rastin kur procedohet ndaj një deputeti të Kuvendit, gjykata verifikon sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 288, pika 1, të KPP-së, vetëm nëse ky autorizim i kërkuar është dhënë, ndërsa dhënia ose jo e autorizimit nga Kuvendi për të hequr imunitetin ose mburojën procedurale ndaj deputetit është në diskrecion të tij dhe ka si qëllim jo të pengojë hetimet, por të mbrojë funksionin e deputetit nga sulmet abuzive të pushteteve të tjera (*shih faqen 14 të vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe paragrafin 52 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

54. Për sa më lart, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e kanë marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesit për ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi, dhe i kanë dhënë

përgjigje të arsyetuar për të. Në vlerësimin e Gjykatës, shqyrtimi i pretendimit për ligjshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi nuk hyn në juridiksionin e gjykatave që shqyrtojnë masat e sigurimit personal. Për këtë arsye, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar[3].

55. Po kështu, referuar pretendimit tjetër të kërkuesit se procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ka qenë e paragjykuar politikisht, bazuar në sa u parashtrua më sipër nga aktet e Kuvendit (procesverbalit të Këshillit dhe dy raporteve rekomanduese), Gjykata çmon se edhe pse gjatë diskutimit të anëtarëve të Këshillit, në mbledhjen e këtij të fundit, nga disa deklarata të anëtarëve të atij Këshilli, vërehen nuanca politike në trajtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme ose edhe paracaktimi i mënyrës së votimit të tyre, kjo është e pranueshme në kontekstin e diskutimeve në një institucion politik të përbërë nga përfaqësues të politikës, siç është Kuvendi, dhe nuk do të thotë se dhënia e autorizimit ka qenë e ndikuar politikisht. Për më tepër që kërkuesi në kërkesën e tij i referohet në tërësi opinioneve/deklaratave dhe pyetjeve të deputetëve anëtarë të Këshillit, por nuk ka treguar dhe nuk ka arritur të provojë se si këto opinione/deklarata ose pyetje kanë paragjykuar vendimmarrjen e Këshillit.

56. Në arritjen e këtij përfundimi, Gjykata ka parasysh edhe se, siç del qartësisht nga diskutimet në Këshill, qëllimi i deklaratave/pohimeve të deputetëve, në kuadër të procedurës parlamentare për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit, ka qenë arsyetimi lidhur me ekzistencën e kushteve për dhënien ose jo të autorizimit dhe jo përcaktimi i fajësisë ose pafajësisë penale të tij. Gjykata thekson, gjithashtu, se fakti që procedura parlamentare për dhënien e autorizimit për heqjen e lirisë së kërkuesit është vënë në lëvizje për shkak të mospërmbushjes nga kërkuesi të detyrimeve të vendosura më parë nga gjykatat, konkretisht për zbatimin e masës së sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", është një tjetër tregues i rëndësishëm i faktit që ajo (procedura) nuk ka qenë e ndikuar politikisht. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata çmon se procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit nuk ka qenë e paragjykuar politikisht dhe pretendimi i tij në këtë drejtim nuk është i bazuar[4].

---

[3] Në vijim të arsyetimit të mësipërm, gjyqtaret Holta Zaçaj dhe Sonila Bejtja vlerësuan se për procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit të deputetit, Gjykata ka juridiksion origjinal për sa i përket ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së saj.

[4] Në vlerësimin e gjyqtareve Holta Zaçaj dhe Sonila Bejtja, në lidhje me pretendimet për procedurën parlamentare Gjykata ka juridiksion origjinal, ndaj e gjejnë të drejtë arsyetimin e gjykatave të zakonshme për mosmarrjen në shqyrtim të këtyre pretendimeve. Në këtë aspekt, kërkuesi mund t'i ishte drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës për kundërshtimin e procedurës parlamentare për dhënien e autorizimit pa qenë e nevojshme t'u drejtohej gjykatave të zakonshme. Thënë kjo, në vlerësimin e këtyre gjyqtareve, procedura parlamentare për heqjen e imunitetit, në kuptim të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës kërkon që Kuvendi, përpara dhënies së autorizimit, siç ka thënë edhe Komisioni i Venecias, të verifikojë dhe garantojë, *së pari,* që shqyrtimi i masës së kërkuar të mos mbartë ngjyrime politike dhe, *së dyti*, që masa e kërkuar të jetë proporcionale dhe e nevojshme për të respektuar balancën mes interesit publik që lidhet me nevojat e procedimit penal dhe garantimit të ushtrimit efektiv të veprimtarisë parlamentare ose të drejtave të deputetëve. Për sa i përket shqyrtimit të kërkesës për heqjen e imunitetit, sipas Komisionit të Venecias Kuvendi nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes dhe nuk duhet në asnjë rrethanë të japë qëndrimin e tij për fajësinë ose jo të deputetit përkatës ose të bazueshmërisë së procedimit penal (*shih raportin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2014)001 (maj 2014)*). Për sa i përket kërkesës që *procedura të mos mbartë ngjyrime politike*, referuar deklaratave të deputetëve anëtarë të Këshillit, sipas procesverbalit të mbledhjes të datës 18.12.2023, anëtarët e Këshillit i kanë drejtuar pyetje prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe mbrojtësve të kërkuesit, konkretisht deputetja K.B. ka pohuar: "*Besoj se ju jeni të qartë se arsyeja që ne po bëjmë këtë mbledhje [...] është në vijim të shkeljeve të klientit tuaj [...]*" (faqja 50). Deputeti E.A., përfaqësues i pakicës parlamentare në Këshill, ka pohuar se "*[...] ka një Kod të Sjelljes së deputetëve në këtë Parlament [...], ku [...] parashikohet se deputeti nuk duhet të përfitojë mbrojtje nga imuniteti*" (faqja 60). Po sipas këtij deputeti "*[...] qëndrimi që ka mbajtur Partia [...], po edhe unë [...], ka qenë që, po sa herë ka një kërkesë për dhënie/lënie imuniteti, në të jemi pro*" (faqja 67); "*zero imunitet për askënd*" (faqja 69). Po kështu, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, deputeti B.Ç., ka pohuar se "*Ne [...] si Grup Parlamentar do të votojmë çdo kërkesë për heqje imuniteti [...]*" (faqja 62). Referuar këtyre qëndrimeve konstatohet se anëtarët e Këshillit e kanë trajtuar kërkesën për autorizim *en bloc,* duke mbajtur qëndrim politik dhe duke mos u ndalur në vlerësimin e saj individualisht. Këto qëndrime, duke pasur parasysh edhe faktin se kallëzimi penal ndaj kërkuesit është paraqitur nga ish-kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, shtetasi T.B., ndaj kryetarit të partisë më të madhe opozitare, nuk japin garanci se procedura parlamentare ka qenë e paanshme, për të treguar se ajo nuk ka mbartur

57. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesit se në procedurën e zhvilluar në Kuvend nuk ka pasur akte provuese mbi bazën e të cilave mbështetet konkluzioni për ekzistencën e faktit penal në ngarkim të tij, Gjykata vlerëson të theksojë se në procedurën për dhënien e autorizimit për arrestimin e deputetit, pra heqjes së imunitetit të tij, nga Kuvendi nuk është i nevojshëm administrimi i të gjithë dosjes gjyqësore në ngarkim të deputetit, por vetëm i atyre akteve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se deputeti ka kryer shkeljen për të cilën kërkohet autorizimi, që në rastin konkret janë vendimet gjyqësore që kanë caktuar më parë masat e sigurimit personal ndaj tij dhe procesverbalet e mbajtura nga oficeri i Policisë Gjyqësore, për (mos)paraqitjen e tij sipas detyrimeve të vendosura në ato vendime. Në këtë rast, Gjykata, bazuar edhe në raportin e Komisionin të Venecias, mbështet qëndrimin e këtij të fundit se organi parlamentar që shqyrton kërkesën për heqjen e imunitetit nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes dhe nuk duhet në asnjë rrethanë të japë qëndrimin e tij për fajësinë ose jo të deputetit përkatës apo bazueshmërinë e procedimit penal. Në këtë rast, duhet të ekzistojë një prezumim themelor se imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit janë të motivuara politikisht (*shih raportin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2014)001 (maj 2014)*). Pra, në vlerësimin e Gjykatës, Kuvendi, në shqyrtimin e kërkesës për heqjen e imunitetit, nuk duhet të vlerësojë përgjegjësinë penale të deputetit dhe as (pa)fajësinë e tij, por vetëm të sigurohet se ekziston dyshimi i arsyeshëm që ai (deputeti) të ketë kryer shkeljet për të cilat kërkohet heqja e imunitetit, si edhe që kjo kërkesë për heqjen e imunitetit parlamentar të mos jetë e ndikuar politikisht.

58. Në këtë kuptim, Gjykata çmon të theksojë se natyra e vendimeve të marra nga organet politike të Kuvendit, siç mund të jetë në rastin konkret Këshilli, të cilat në vetvete kanë natyrë politike, nuk mund të jetë e njëjtë me natyrën e një vendimi gjyqësor. Për këtë arsye ai jo domosdoshmërisht duhet të plotësojë të njëjtat kritere të një vendimi gjyqësor. Gjithashtu, Gjykata thekson se edhe pse procedura parlamentare për heqjen e imunitetit duket sikur ndërhyn në parimin e prezumimit të pafajësisë, për shkak se mund të perceptohet si një lloj gjykimi politik për themelin e çështjes së (pa)fajësisë së deputetit, kjo procedurë nuk duhet kurrsesi të ketë natyrën e një procedimi gjyqësor ose t'i ngjajë atij, dhe në asnjë rast organi që zhvillon këtë procedurë nuk duhet të vlerësojë (pa)fajësinë e deputetit të cilit kërkohet t'i hiqet imuniteti, e cila vlerësohet vetëm nga gjykatat. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson të ripohojë qëndrimin e saj se imuniteti i deputetit

---

ngjyrime politike. Nga ana tjetër, *në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për autorizim* edhe pse procedura e zhvilluar nga Kuvendi nuk është e njëjtë me atë që bën gjykata, sipas Komisionit të Venecias, e referuar edhe nga shumica, kjo ka të bëjë me ndalimin e organit parlamentar që të bëjë vlerësim ligjor në drejtim të fajësisë së deputetit ose bazueshmërisë së procedimit penal. Thënë kjo, Kuvendi, edhe pse nuk merr atributet e një organi gjyqësor, thirret në këtë rast për të shqyrtuar nëse kërkesa për kufizimin e lirisë së deputetit nuk është haptazi e pabazuar, pra nëse ajo është bërë në përputhje me kriteret dhe kushtet ligjore dhe nëse respekton raportin mes qëllimit të procedimit penal dhe garantimit të autoritetit dhe legjitimitetit të Kuvendit. Referuar raporteve rekomanduese të Këshillit, atij të shumicës dhe pakicës parlamentare, duket se ato (raportet) kanë bërë një vlerësim ligjor të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit, me qëllim zëvendësimin e masës së mëparshme të sigurimit, duke analizuar kriteret dhe kushtet ligjore që lejojnë caktimin e masës kufizuese të lirisë, çka është në kundërshtim me qëndrimin e Komisionit të Venecias. Vlerësimi që bën Kuvendi në procedurën për shqyrtimin e kërkesës për heqjen e imunitetit të deputetit është në funksion të vlerësimit të proporcionalitetit të masës kufizuese të lirisë, duke vënë në balancë nevojën e saj për qëllime të procedimit penal dhe pamundësinë e ushtrimit të mandatit të deputetit si rrjedhojë e kufizimit të lirisë, çka rezulton të mungojë në rastin konkret. Kjo merr rëndësi në situatën kur kufizimi i lirisë ndaj kërkuesit nuk ka qenë i nevojshëm në fillimin e procedimit penal, por është kërkuar nga prokuroria jo për shkak të rëndimit të nevojave të sigurimit, pra për shkak të ndryshimit të tyre krahasimisht me momentin e caktimit të masës së parë, por për mospërmbushjen e detyrimeve të masës "Detyrimi për t`u paraqitur në Policinë Gjyqësore". Në këto kushte, analiza e proporcionalitetit të masës kufizuese të lirisë së kërkuesit është detyra kryesore e Kuvendit dhe arsyeja se përse ky organ është thirrur në këtë procedurë, si garanci për ushtrimin e mandatit të deputetit në emër të ruajtjes së funksionalitetit të vetë Kuvendit. Për rrjedhojë, për shkak të mënyrës se si është zhvilluar procedura e shqyrtimit të kërkesës për autorizim në rastin konkret, si referuar deklaratave dhe qëndrimeve të anëtarëve të Këshillit, ashtu edhe për shkak të mungesës së analizës në drejtim të proporcionalitetit të masës së kërkuar dhe votimit të saj *en bloc,* këto gjyqtare janë të qëndrimit se kjo procedurë nuk ka përmbushur garancitë e kërkuara kushtetuese.

nuk përbën përjashtim nga rregulli, sipas të cilit çdo person që kryen një vepër penale është subjekt i përgjegjësisë penale, që ndiqet nga prokurorët dhe në fund vendoset nga gjykatat e pavarura (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Për këtë arsye, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata vlerëson se aktet e paraqitura nga organi i akuzës për dhënien nga Kuvendi të autorizimit për arrestimin e kërkuesit, pra heqjes së imunitetit të tij, duket se sjellin mjaftueshëm të dhëna për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit, nuk është i bazuar[5].

B. 1.2.2. Për cenimin e procedurës gjyqësore

B.1.2.2.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

60. Kërkuesi ka pretenduar se arsyetimi i gjykatave për procedurat për përjashtimin e gjyqtares është telegrafik dhe vendimet përmbajnë të dhëna kontradiktore dhe nuk u kanë dhënë zgjidhje të plotë e shteruese pretendimeve të ngritura prej tij. Po ashtu kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit nuk ka arsyetuar se përse ka refuzuar marrjen e provave të tij dhe se arsyetimi arbitrar i asaj gjykate nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë. Po sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë arsyetuar pretendimin e tij në lidhje me mosekzistencën e kushtit procedural "Shkelja e detyrimeve që lidhen me një masë tjetër sigurimi", të parashikuar nga neni 231 i KPP-së, duke qenë se vendimet me cilat janë caktuar masat e sigurimit nuk i janë njoftuar atij.

61. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar duke argumentuar se vendimet e gjykatave nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore, të paqarta ose në mungesë të elementeve formale, duke plotësuar kështu elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Sipas Prokurorisë së Posaçme, gjykatat i kanë dhënë përgjigje kërkuesit për pretendimet e ngritura prej tij.

62. Në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës, e drejta e aksesit i garanton individit të drejtën t'i drejtohet një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tij dhe do të shpallë një vendim që u jep përgjigje atyre (pretendimeve), përfshirë edhe pretendimet që mund të ngrihen nga pala tjetër, e ndryshme nga kërkuesi, në kuadër të ankimeve që mund të bëhen gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi *(shih vendimet nr. 73, datë 17.10.2024; nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 29, datë 1.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

63. Nga ana tjetër, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017*

---

[5] Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi se pretendimi i kërkuesit për procedurën parlamentare është i bazuar. Në vendimin nr. 81/2024 kjo gjyqtare ka mbajtur qëndrimin në pakicë se është cenuar procedura parlamentare për heqjen e imunitetit të kërkuesit, për sa kohë që Prokuroria e Posaçme, në kundërshtim me nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, nuk ka marrë autorizimin e Kuvendit për caktimin masës së sigurimit personal "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", të caktuar së bashku me masën tjetër "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", çka ka qenë edhe pretendimi kryesor i ngritur nga kërkuesi në gjykatat e zakonshme dhe në vijim në Gjykatë. Për rrjedhojë, në linjë me atë qëndrim, për sa kohë që vendimi për masën e sigurimit që nuk është përmbushur nga kërkuesi, çka ka sjellë edhe zëvendësimin e masave të vendosura më parë ndaj tij me një masë më të ashpër të sigurimit personal, konkretisht "Arresti në shtëpi", objekt i këtij gjykimi, është marrë mbi një procedurë jokushtetuese, ai vendim që caktonte ato masa, nuk mund të sillte asnjë pasojë, për rrjedhojë edhe ato nuk mund të sillnin asnjë pasojë ndaj lirisë personale të kërkuesit. Kjo do të thotë se mosrespektimi i procedurës parlamentare për shkak të mosmarrjes së autorizimit, si një kërkesë kushtetuese, shkelja e së cilës ka vesuar të gjithë procesin për caktimin e masave kufizuese të lirisë sjell pasoja të drejtpërdrejta edhe në procesin e zëvendësimit të atyre masave, duke e vesuar edhe këtë proces nga pikëpamja kushtetuese. Për këto arsye, për sa kohë që në vlerësimin e kësaj gjyqtareje caktimi i masës së kundërshtuar është në kundërshtim me Kushtetutën për arsyet si më sipër, ajo nuk ndalet më tej në vlerësimin e kritereve të tjera ligjore në caktimin e masave kufizuese të lirisë, për rrjedhojë as në proporcionalitetin e saj.

të Gjykatës Kushtetuese). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 24, datë 9.4.2024; nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 34, datë 13.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata do të analizojë në vijim nëse në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me shkaqet që kanë çuar në pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit dhe caktimin ndaj tij të masës "Arresti në shtëpi", si në drejtim të kritereve dhe kushteve për caktimin e masave të sigurimit me natyrë shtrënguese, ashtu edhe në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi dhe nëse ky arsyetim plotëson standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

66. Gjykata vëren se me kërkesën e datës 22.12.2023, Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenet 228-232, 237, 244 dhe 260 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata zëvendësimin e masave të sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", të vendosura më parë ndaj kërkuesit, me masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", për shkak se kërkuesi nuk ka zbatuar vendimin e gjykatave, edhe për pasojë edhe një prej masave të sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij, duke mos u paraqitur asnjëherë përpara Policisë Gjyqësore.

67. Pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme dhe ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", duke e urdhëruar atë të mos largohej nga banesa, si dhe të mos komunikonte me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të. Sipas gjykatës, kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimet e tij që vijnë si rezultat i zbatimit dhe respektimit të vendimeve nr. 112/2023 dhe 117/2023 të GJKKO-së së Shkallë së Parë, duke mos u paraqitur përpara Policisë Gjyqësore në katër raste. Sipas asaj gjykate, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, i KPP-së), se ai është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se nuk ka zbatuar në mënyrë të përsëritur detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore, për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur para oficerit të Policisë Gjyqësore dhe duke mos paraqitur asnjë arsye të qenësishme që të justifikojë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në vendimet e gjykatës. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se në rastin konkret nevojat e sigurimit vijojnë të jenë në të njëjtin stad, por duke qenë se nga ana e kërkuesit, në mënyrë të përsëritur, janë shkelur detyrimet lidhur me zbatimin e masave të sigurimit personal të caktuara nga gjykata, në raport me parashikimet e nenit 228, pika 3, të KPP-së, është para kushteve kur duhet të zëvendësohen ato masa me një masë tjetër më të rëndë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuesit janë të tilla që justifikojnë masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", duke qenë se çështja ndodhet në fazën e hetimeve dhe nga ana e organit të akuzës duhet të kryhen ende veprime hetimore, dhe se kërkuesi, për shkak të marrëdhënieve të krijuara për shkak të statusit të tij të mëparshëm si Kryeministër i vendit ose atij aktual, si deputet i Kuvendit, mund të ndikojë ose ndërhyjë në

prishjen apo asgjësimin e provave, si edhe krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çka, sipas tyre, do të sillte një hetim të mangët. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistojnë akoma rrethanat që kërkuesi mund të largohet. Për këto arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke marrë në konsideratë mosrespektimin e urdhërimeve të gjykatës nga kërkuesi, të përcaktuara në vendimin e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj tij, të shoqëruar edhe me ekzistencën e kushteve dhe kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të normuara në nenin 228 të KPP-së, ka vlerësuar se justifikohet zëvendësimi i masave të sigurimit personal nga "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit",* në atë "*Arresti në shtëpi*" (*shih faqet 33 e në vijim të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

68. Gjatë gjykimit në GJKKO-në e Shkallës së Parë, kërkuesi në datën 26.12.2023 ka paraqitur pranë asaj gjykate kërkesën me objekt përjashtimin e gjyqtares I.Gj. nga shqyrtimi i çështjes. Referuar materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se sipas urdhrit nr. 381, datë 4.12.2023 të zëvendëskryetares së GJKKO-së së Shkallës së Parë, është bërë përditësimi i ndarjes së gjyqtarëve sipas gatishmërisë për muajin dhjetor të vitit 2023. Po ashtu, rezulton se në datën 26.12.2023, zëvendëskryetarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë ka nxjerrë urdhrin nr. 418, datë 26.12.2023, sipas të cilit, duke qenë se dy gjyqtarë të asaj gjykate, përkatësisht gjyqtaret F.H. dhe E.D., kishin rënë dakord për zëvendësimin e njëra-tjetrës në gatishmërinë përkatëse, sipas shkresës nr. 3572, prot., datë 26.12.2023, bazuar në nenin 37, paragrafi "b", të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar (*ligji nr. 98/2016*), ka urdhëruar përditësimin e ndarjes së gjyqtarëve sipas gatishmërisë. Ndërkohë, rezulton se sipas vendimit nr. 57, datë 20.11.2023 "Për dhënien e lejes", zëvendëskryetarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë ka miratuar kërkesën e gjyqtares E.D. për dhënien e lejes vjetore për periudhën 26.12.2023–29.12.2023. Kështu, me urdhrin nr. 421, datë 26.12.2023, zëvendëskryetarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke qenë se vetë ajo si gjyqtare e gatshme nuk mund të merrte në shqyrtim kërkesën e kërkuesit për përjashtim, si edhe duke qenë se gjyqtarja pasardhëse e gatshme, E.D., ishte me leje vjetore, ka caktuar gjyqtaren R.P. si gjyqtare pasardhëse të gatshme për të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjes. Gjyqtarja R.P., pasi administroi edhe mendimin e vet gjyqtares I.Gj. për këtë kërkesë të kërkuesit, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, ka vendosur deklarimin e papranueshmërisë së saj. Gjithashtu, rezulton se kërkuesi ka paraqitur përsëri një kërkesë për përjashtimin e gjyqtares I.Gj., e cila ka mbërritur në atë gjykatë në datën 3.1.2024 dhe nuk është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 23, datë 5.1.2023, për shkak se në datën 30.12.2023 ishte zhvilluar gjykimi i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për zëvendësimin e masës së sigurimit të caktuar ndaj kërkuesit. Pra, kërkesa për përjashtim ishte paraqitur pas dhënies së vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit.

69. Mbi ankimin e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024, ka arsyetuar se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi për përjashtimin e gjyqtares I.Gj. nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 20, pika 1, i KPP-së, dhe për këtë arsye nuk përmbush kushtet për pranueshmërinë e saj. Sipas asaj gjykate, e gjithë procedura e ndjekur nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për caktimin e gjyqtares që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtares I.Gj. nga shqyrtimi i çështjes, është në përputhje me përcaktimet e ligjit procedural penal dhe kërkesat ligjore të dispozitave të neneve 18 dhe 19 të KPP-së. Për këto arsye, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se nuk ka pranuar të marrë në shqyrtim vendimmarrjen e shpallur më pas, *ex post,* nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë, sepse ai ishte i panevojshëm për vendimmarrjen. Sipas GJKKO-së së Apelit, i pabazuar është edhe shkaku tjetër i ngritur në ankim nga kërkuesi, sipas të cilit gjyqtarja I.Gj. nuk ka pranuar provat e paraqitura nga ai, pasi një vlerësim/çmuarje e tillë nga ajo gjyqtare është bërë në ushtrimin e funksionit gjyqësor të çështjes konkrete dhe në përputhje me diskrecionin e saj të lejuar nga ligji procedural penal (*shih faqet 11-13 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar njësoj si GJKKO-ja e Shkallës së Parë se kërkuesi ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi

ndaj tij. Edhe sipas asaj gjykate, masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi" është në përputhje me kërkesat e nenit 229, pika 2, të KPP-së, që i referohet kriterit të proporcionalitetit ose përzgjedhjes së masës së sigurimit personal në raport të drejtë mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale të atribuar ose dënimit të mundshëm. Lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave të kërkuesit në kufizim të lirisë së tij të komunikimit dhe të së drejtës së shprehjes, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në respektim të kufijve diskrecionalë të caktuar nga pika 2 e nenit 237 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka përzgjedhur një kufizim që është proporcional dhe i motivuar nga interesi publik që prevalon mbi interesin personal të individit (*shih faqet 15 e vijuese të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

70. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta kanë interpretuar drejt ligjin, duke zbatuar të njëjtat procedura e garanci, sikurse edhe në rastet e tjera të ankimimit kundër masave të sigurimit (neni 249), përfshirë këtu garancitë e lidhura me të drejtat e liritë themelore të njeriut për zhvillimin e një gjykimi të kujdesshëm (diligjent) dhe me shpejtësi të çështjeve të kësaj natyre (*shih paragrafin 44 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Lidhur me pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë, ai kolegj ka vlerësuar se janë të pambështetura në ligj e prova, pasi, në thelb, mbështeten tek ushtrimi i vendimmarrjes nga gjyqtari, si edhe te drejtimi dhe menaxhimi i procesit gjyqësor (nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve) konform tagrave që i njeh ligji. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet në lidhje me njëanshmërinë e gjyqtares, sipas nenit 17, pika 1, shkronja "e", të KPP-së, janë të pabazuara dhe kanë marrë përgjigje të argumentuara si nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë që ka disponuar me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, po ashtu edhe nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka shqyrtuar ankimin edhe ndaj këtij vendimi, duke u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të të hetuarit. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se duke mbajtur në konsideratë këto fakte, edhe pretendimi i kërkuesit për shkelje nga GJKKO-ja e Apelit, që nuk ka pranuar si provë vendimmarrjen e GJKKO-së së Shkallës së Parë për kërkesën e dytë për përjashtim, nuk e cenon vendimmarrjen objekt rekursi, pasi kjo provë nuk ndikon dhe as passjell një vendimmarrje të ndryshme, e si e tillë me të drejtë është konsideruar një provë e panevojshme (*shih paragrafët 44, 48, 50 dhe 51 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

71. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se pjesa e pretendimeve që lidhen me vlerësimin e rrethanave të faktit del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, por, megjithatë, ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenet 231 dhe 260 të KPP-së, për zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është arsyetuar dhe vlerësuar drejt nga të dyja gjykatat, të cilat kanë verifikuar shkeljen e detyrimeve që burojnë nga masa sigurimit personal në fuqi në raport me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes së kryer (pranuar si të tillë nga të dyja gjykatat). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, masa e sigurimit është zëvendësuar *in peius* ndaj kërkuesit në zbatim të neneve 231 dhe 260, pika 3, të KPP-së, për shkak se ai ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij dhe jo për shkak se nevojat e sigurimit janë rënduar. Kolegji Penal, në vlerësimin e tij, ka arsyetuar se gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë vijimësinë e nevojave të sigurimit të evidentuara në gjenezë të caktimit të masës së sigurimit personal sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së dhe arsyen e zëvendësimit të llojit të masës së sigurimit personal, për shkakun e evidentuar qartësisht në arsyetimin e vendimmarrjes së tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se të dyja gjykatat kanë analizuar dhe evidentuar vijimësinë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer një vepër penale, kusht ky *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të një mase sigurimi personale. Sipas atij Kolegji, gjykatat më të ulëta i kanë vlerësuar aktuale nevojat e sigurimit, duke evidentuar "shmangien e dëmtimit të hetimeve" dhe "ikjen e kërkuesit" (dy rreziqe të evidentuara që në gjenezë), si dhe kanë arsyetuar përshtatshmërinë e llojit të masës shtrënguese "Arresti në shtëpi" me nevojat e sigurimit sipas rrethanave të rastit konkret. Kolegji Penal ka arsyetuar edhe në lidhje me ndalimet e urdhëruara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për të mos komunikuar me persona të tjerë veç atyre që bashkëjetojnë me të në banesë, të cilat, sipas atij kolegji, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe nuk përbëjnë shkak për

cenimin e vendimmarrjes objekt rekursi (*shih paragrafët 52-58 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

72. Për sa më lart, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit), në vlerësimin e tyre për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për arsyet të cilat kanë justifikuar zëvendësimin e saj, duke shfaqur një kujdes të veçantë në realizimin e procesit ndaj tij, si dhe duke arsyetuar për masën e duhur të sigurimit personal dhe nëse ishte e "mjaftueshme" për të arritur qëllimin për të cilën ishte kërkuar, që lidhej me mospërmbushjen nga ai të detyrimeve të vendosura më parë nga gjykatat. Po kështu, ato (gjykatat) kanë analizuar se vazhdon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, rrezikun që paraqet për t'iu shmangur hetimit, si edhe prishjes ose të vërtetësisë së provave, nëse ndaj tij nuk do të vendosej ajo masë e sigurimit personal.

73. Në vlerësimin e gjykatës, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, arsyetimi i GJKKO-së së Apelit dhe i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me procedurat për përjashtimin e gjyqtares, rezulton se i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimit të tij të ngritur në ankim/rekurs. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata konstaton se edhe arsyetimi i atyre gjykatave për këtë pjesë të vendimit nuk rezulton të jetë kontradiktor, telegrafik ose arbitrar. Po ashtu, Gjykata evidenton se gjykatat kanë arsyetuar në vendimet e tyre edhe për pretendimin e ngritur nga kërkuesi për kërkesën për përjashtim të paraqitur nga ai (*shih faqen 11 të vendimit të GJKKO-së Apelit dhe paragrafët 50 e në vijim të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*), dhe se ky arsyetim i tyre, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimit të tij dhe nuk rezulton kontradiktor ose arbitrar, duke plotësuar kështu standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

74. Në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së zëvendësimit të masës së sigurimit personal dhe nevojave të sigurimit në rastin konkret, krahas vendosjes së masës konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë analizuar dhe vlerësuar edhe rëndësinë e faktit se kërkuesi në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar detyrimet për zbatimin e njërës prej masave të sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij, që është bërë shkak për vendosjen e masës konkrete. Pra, në këtë kuptim, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat kanë arsyetuar edhe në lidhje me ekzistencën e kushtit procedural/ligjor për zëvendësimin e masës së sigurimit, duke qenë se ai ishte në dijeni dhe ishte njoftuar për vendimet gjyqësore, të cilat kishin caktuar masën e sigurimit personal ndaj tij, moszbatimi i së cilës u bë shkak për zëvendësimin me masën tjetër "Arresti në shtëpi". Për më tepër, Gjykata rithekson qëndrimin e saj në vendimin nr. 81/2024 lidhur me këtë pretendim, ku ajo (Gjykata) pajtohet me vlerësimin e gjykatave të zakonshme se kërkuesi ishte në dijeni dhe ishte njoftuar për vendimet gjyqësore, të cilat kishin caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. Prandaj, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit ka marrë përgjigje të arsyetuar me vendimin nr. 81/2024 të Gjykatës.

75. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjykatat kanë evidentuar edhe faktin se duke qenë se çështja ndodhet në fazën e hetimeve dhe nga ana e organit të akuzës duhet të kryhen ende veprime hetimore, kërkuesi, për shkak të marrëdhënieve të krijuara prej statusit të tij të mëparshëm si Kryeministër i vendit ose atij aktual, si deputet i Kuvendit, mund të ndikojë ose ndërhyjë në prishjen apo asgjësimin e provave, si edhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çka, sipas tyre, do të sillte një hetim të mangët. Po ashtu, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në faktet dhe informacionet e administruara rregullisht gjatë procesit, kanë analizuar mjaftueshëm për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale nga kërkuesi, sikundër edhe për ekzistencën e kushteve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit personal.

76. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, Gjykata konstaton se gjykatat i kanë dhënë përgjigje për pretendimet kryesore të tij, përfshirë këtu edhe pretendimin për mosarsyetimin nga GJKKO-ja e Apelit për mosmarrjen e provës (*shih faqen 13 e vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Në këtë

kuptim, rezulton se gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese në lidhje me objektin e çështjes së paraqitur për shqyrtim përpara tyre dhe thelbin e pretendimeve të ngritura nga kërkuesi. Referuar arsyetimit të vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesi, të pasqyruara më sipër në këtë vendim, ndryshe nga sa pretendon ai, Gjykata vëren se në tërësinë e tyre ato nuk rezultojnë arbitrare, telegrafike në lidhje me procedurat e përjashtimit të gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë, jologjike dhe të pamjaftueshme, si dhe kontradiktore ose të paqarta për sa u përket të dhënave të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ato nuk cenojnë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

77. Nisur nga sa më sipër, bazuar në standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata vëren se edhe Kolegji Penal i ka pasqyruar në vendimin objekt kundërshtimi shkaqet e ngritura në rekursin e ushtruar nga kërkuesi dhe pasi i ka marrë në shqyrtim ato, i ka gjetur të pabazuara, duke vlerësuar, në thelb, se nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka dhënë argumente të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave ka arritur në mënyrën e përfundimit të çështjes. Gjithashtu, bazuar në standardet kushtetuese dhe referuar në tërësi përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se edhe ai i përmbush elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ai ka respektuar elementet formale, duke pasqyruar të dhënat e palëve në procesin gjyqësor penal, shkaqet e parashtruara në ankim dhe rekurs, vendimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ka mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimi nuk rezulton të jetë arbitrar, alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e tij. Për rrjedhojë vendimi i Kolegjit Penal nuk vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të aksesit dhe standardit të arsyetimit të tij.

78. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore janë të pabazuara.

B.1.2.2.2 Për cenimin e parimit të paanshmërisë

79. Kërkuesi ka pretenduar se gjyqtarja I.Gj., e cila ka dhënë ndaj tij masën shtrënguese të sigurimit personal "Arresti në shtëpi", është shkarkuar nga detyra e gjyqtares në vitin 1996, nga ish-KLD-ja, kohë kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi, në cilësinë e Presidentit të Republikës. Sipas kërkuesit, ai ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e kësaj gjyqtareje, e cila është shqyrtuar nga një gjyqtare tjetër e GJKKO-së së Shkallës së Parë, e caktuar po nga gjyqtarja I.Gj., në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, dhe në përfundim, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, ajo kërkesë nuk është pranuar. Po sipas kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim vendimin e ndërmjetëm nr. 23, datë 5.1.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë për papranueshmërinë e kërkesës për përjashtimin e gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë për shkaqe anshmërie.

80. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka paraqitur asnjë argument për të prapësuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë në drejtim të testit subjektiv. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e mbrojtjes efektive, Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se ai është i pabazuar, pasi gjatë gjithë kohës që ka qenë nën masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", kërkuesi ka komunikuar vazhdimisht me mbrojtësit e tij. Sipas Prokurorisë së Posaçme, kjo konfirmohet edhe nga ankimet e bëra nga ai ndaj vendimit të caktimit të masës së sigurimit në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor, përfshirë edhe ankimin në këtë Gjykatë.

81. Neni 28 pika 2, i Kushtetutës parashikon se paraburgimi ose lirimi i individit vendoset nga gjyqtari. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata çmon se ai duhet të përmbushë garancitë kushtetuese të gjykatës së pavarur dhe të paanshme të përcaktuara nga neni 42 i Kushtetutës. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm

formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

82. Gjykata ka theksuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë *(shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar *(shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

83. Bazuar në sa më sipër, Gjykata do të shqyrtojë në vijim nëse shqyrtimi nga gjyqtarja I.Gj. i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për zëvendësimin e masave të sigurimit personal të caktuara ndaj kërkuesit ka vënë në dyshim respektimin e parimit të paanshmërisë në aspekt të testit subjektiv në atë gjykim dhe nëse gjykatat më të larta i kanë garantuar atij të drejtën e mbrojtjes efektive, duke shqyrtuar pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë.

84. Gjykata, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, vëren se gjyqtarja I.M. (I.Gj.) ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe me vendimin nr. 7, datë 8.2.1996 të ish-KLD-së është shkarkuar për shkak të paaftësisë në kryerjen e detyrës. Në atë kohë rezulton që kryetar i ish-KLD-së të ketë qenë kërkuesi, për shkak të funksionit të tij si President i Republikës, funksion ky *ex officio* sipas legjislacionit në fuqi. Rezulton, gjithashtu, që kjo gjyqtare të jetë emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mallakastër me vendimin nr. 8, datë 23.8.1996 të po ish-KLD, e cila edhe në atë kohë drejtohej po nga kërkuesi.

85. Ndërkohë, GJKKO-ja e Apelit, duke iu referuar edhe arsyetimit të vendimit nr. 521, datë 27.12.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtares I.Gj., ka vlerësuar se ajo (kërkesa e paraqitur nga kërkuesi për përjashtimin e gjyqtares I.Gj.) nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 20, pika 1, i KPP-së, dhe për këtë arsye nuk përmbush kushtet e pranueshmërisë së saj (*shih faqen 11 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Edhe sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pretendimet e kërkuesit për njëanshmërinë e gjyqtares I.Gj., referuar nenit 17, pika 1, shkronja "ë", të KPP-së, janë të pabazuara dhe kanë marrë përgjigje të arsyetuar si nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, ashtu edhe nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka shqyrtuar ankimin ndaj këtij vendimi, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit (*shih paragrafin 50 i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

86. Gjykata, referuar përmbajtjes së dispozitave kushtetuese në fuqi në kohën kur është dhënë vendimi nr. 7, datë 8.2.1996 i ish-KLD-së, vëren se gjyqtari mund të shkarkohej nga ai organ [...] për pamjaftueshmëri profesionale (*neni 147, pika 6*). Ish-KLD-ja përbëhej nga Presidenti i Republikës, kryetari Gjykatës së Lartë, ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, si dhe nëntë gjyqtarë të të gjitha niveleve [...] (*neni 147, pika 1*). Bazuar në përmbajtjen e këtyre dispozitave, Gjykata vëren se shkarkimi i gjyqtarëve bëhej nga një organ kolegjial (ish-KLD-ja), vendimet e të cilit, si rregull, merren sipas formulës së parashikuar për shumicën e votave të anëtarëve të tij, ndërkohë që nuk rezulton dhe nuk është provuar nga kërkuesi që ai, në cilësinë e kryetarit të këtij organi, të ketë pasur votë përcaktuese në këtë drejtim. Pavarësisht se kërkuesi ka ushtruar në atë kohë detyrën e kryetarit të ish-KLD-së, nuk rezulton që ai të ketë vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj gjyqtares I.Gj. ose të ketë pasur ndonjë rol përcaktues në procedimin disiplinor ndaj saj.

87. Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Gjykata evidenton se qenia e kërkuesit në cilësinë e kryetarit të një organi kolegjial, i cili ka disponuar për lirimin nga detyra të gjyqtares I.Gj., nuk është shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e asaj gjyqtareje në këtë rast, për sa kohë nuk rezulton dhe nuk është provuar që ai (kërkuesi), në cilësinë e kryetarit të atij organi, të ketë pasur votë përcaktuese në këtë drejtim ose të ketë vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj gjyqtares apo të ketë pasur ndonjë rol përcaktues në procedimin disiplinor ndaj saj. Për më tepër, siç edhe rezulton nga aktet bashkëlidhur kërkesës, gjyqtarja I.Gj. edhe pse është shkarkuar nga detyra e gjyqtares në vitin 1996 nga ish-KLD-ja, kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi, në cilësinë e Presidentit të Republikës, është rikthyer në detyrë, në të njëjtin vit, po nga ish-KLD-ja e drejtuar nga kërkuesi, çka tregon se pretendimet që lidhen me shkarkimin e asaj gjyqtareje neutralizohen nga riemërimi më pas i saj. Në vlerësimin e Gjykatës, ky fakt nuk është i mjaftueshëm për të treguar paragjykimin e gjyqtares I.Gj. në drejtim të vlerësimit të kërkesës së prokurorisë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit.

88. Gjithashtu, Gjykata konstaton se nga gjyqtarja I.Gj. nuk është kryer asnjë veprim ose sjellje konkrete që të vërë në dyshim paanshmërinë e saj në drejtim të testit subjektiv. Veprimet e gjyqtares I.Gj., në cilësinë e zëvendëskryetares së GJKKO-së së Shkallës së Parë, për caktimin e një gjyqtareje tjetër për shqyrtimin e kërkesës së kërkuesit për përjashtimin e saj nga shqyrtimi i çështjes, janë kryer në ushtrimin nga ajo të detyrave administrative dhe menaxhuese në drejtimin e asaj gjykate dhe lidhen vetëm me funksionin e saj si zëvendëskryetare, ndaj për këtë arsye nuk ndikojnë në paanshmërinë e saj. Në vlerësimin e Gjykatës, nga gjyqtarja I.Gj. është ndjekur procedura e zakonshme në përditësimin e listës që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, që në rastin konkret lidhet me zëvendësimin e gjyqtarëve të gatshëm dhe këto veprime nuk ngrenë dyshime për paanshmërinë e saj, për shkak se nga ajo është vepruar në përputhje me parashikimet e KPP-së dhe ligjit nr. 98/2016, , si edhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

89. Në këtë kuptim, Gjykata arrin në përfundimin se gjyqtarja I.Gj. ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm për paanshmërinë e saj në gjykimin e çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete nuk ka arsye të përligjura që rrezikojnë dhe vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtares I.Gj. dhe ky dyshim nuk është objektivisht i justifikueshëm. Gjithashtu, Gjykata evidenton se nga GJKKO-ja e Apelit janë dhënë arsyet dhe është arsyetuar për mosmarrjen në shqyrtim të provës së paraqitur nga kërkuesi, për shkak se ajo ishte e panevojshme për gjykimin konkret (*shih faqen 13 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Për këtë arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim nuk është i bazuar. Për më tepër, Gjykata evidenton se kërkesa e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtares I.Gj. është marrë në shqyrtim nga një gjyqtare tjetër e së njëjtës gjykatë dhe i është dhënë përgjigje e arsyetuar, si edhe, po ashtu, ky pretendim është parashtruar edhe në ankimet në gjykatat më të larta, të cilat, pasi e kanë marrë në shqyrtim, i kanë dhënë përgjigje kërkuesit se është i pabazuar (*shih faqet 11-13 të GJKKO-së së Apelit dhe paragrafët 44-51 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

90. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë nuk përbëjnë shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtares I.Gj. në drejtim të testit subjektiv. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ato nuk janë të bazuara.

B.2. Për aspektin substancial

B.2.1 Për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për të ushtruar veprimtarinë parlamentare

91. Kërkuesi ka pretenduar se me zëvendësimin e masës së sigurimit personal, atij i janë kufizuar edhe të drejta dhe liri të tjera të parashikuara nga Kushtetuta, siç janë e drejta për jetë familjare, liria e shprehjes, liria e organizimit, e drejta për të ushtruar mandatin parlamentar dhe se kufizimi i tyre është bërë pa ligj. Sipas tij, kufizimi nuk është proporcional dhe gjykatat nuk kanë arsyetuar pse nevojat e sigurimit nuk garantoheshin me masa më të lehta sigurimi, siç janë "Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar" dhe "Garancia pasurore", si edhe se gjykatat nuk mund të përcaktojnë kufizime tej atyre të përcaktuara nga ligji.

92. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se gjykatat kanë argumentuar nevojshmërinë e masës së sigurimit personal, duke bërë një analizë tërësore të rezultateve të hetimit dhe në këtë mënyrë kanë konkluduar me vendimmarrje në përputhje me dispozitat përkatëse. Sipas Prokurorisë së Posaçme, edhe pse me masë sigurimi "Arresti në shtëpi", kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të shprehjes, lirinë politike dhe atë të organizimit dhe se kushtet dhe kriteret në caktimin e masave të sigurimit janë analizuar qartësisht nga gjykatat.

93. Bazuar në sa më sipër, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara, që kanë caktuar ndaj kërkuesit një masë sigurimi më të rëndë, atë "Arresti në shtëpi", duke kufizuar lirinë e tij personale, i kanë kufizuar edhe të drejtën për të ushtruar veprimtarinë parlamentare, në kuptim të së drejtës për t'u zgjedhur, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës. Nëse përgjigjja e kësaj pyetjeje është pozitive, Gjykata do të vlerësojë më tej nëse kjo ndërhyrje është e ligjshme dhe në respektim të kushteve e kritereve të përcaktuara në nenet 228, 229 e vijues të KPP-së, si dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Për këtë qëllim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe parimin e subsidiaritetit, do të verifikojë në nëse gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar dhe interpretuar në drejtim të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sigurimit të caktuar ndaj tij, si dhe nëse kanë mbajtur në konsideratë se ajo përmbush qëllimin për të cilin është caktuar.

94. Në lidhje me të drejtën për t'u zgjedhur, Gjykata evidenton se ajo garantohet nga neni 45 i Kushtetutës dhe, sipas kësaj dispozite, çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u zgjedhur shtrihet jo vetëm mbi të drejtën për të kandiduar, por edhe mbi të drejtën për të ushtruar funksionin publik të besuar nga zgjedhësit (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

95. Ndërkohë, Gjykata ripohon se çdo masë që kufizon liritë dhe të drejtat e individit duhet të jetë në përputhje me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave e lirive të tij. Një ndërhyrje do të konsiderohet "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për një qëllim të ligjshëm nëse i përgjigjet një "nevoje sociale urgjente" dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë janë "relevante dhe të mjaftueshme". Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për aq sa ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Vlerësimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes bazohet në tri shtylla kryesore: justifikimi i kufizimit nën dritën e funksionit të tij mbrojtës; cilësia e vlerësimit të brendshëm; ashpërsia e kufizimit (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

96. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se çdo kufizim i lirisë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individëve nga arbitrariteti dhe se ai do të konsiderohet arbitrar, midis të tjerash, në rastet kur nuk është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur. Mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e autoriteteve për faktet e çështjes për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm do të përbënte cenim të lirisë personale. Në këtë drejtim, Gjykata ka identifikuar disa shkaqe që konsiderohen të pranueshme për të justifikuar ndërhyrjen në lirinë personale, siç janë: a) rreziku që i dyshuari/akuzuari në qoftë se do të lihej i lirë do të largohej dhe nuk do të paraqitej përpara gjykatës; b) rreziku që i dyshuari/akuzuari, në qoftë se do të lihej i lirë do të ndërmerrte veprime për të penguar dhënien e drejtësisë; c) rreziku që i dyshuari/akuzuari nëse do të lihej i lirë do të kryente vepra penale të tjera (*shih vendimin nr. 19, datë 21.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

97. Në lidhje me kriteret që duhet të plotësohen për të justifikuar nga pikëpamja kushtetuese kufizimin e lirive dhe të të drejtave kushtetuese, Gjykata vëren se lidhur me interesin publik, rregullat procedurale penale që lejojnë vendosjen e masave të sigurimit personal i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal të lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj ai është i prezumuar (*shih vendimin nr. 83, datë 5.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtat e tij kushtetuese është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik.

98. Në vijim, në drejtim të kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata analizon aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijues të KPP-së. Në lidhje me kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis masave të sigurimit personal dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata do të analizojë nevojën për kufizimin e lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë parlamentare në raport me nevojat konkrete për mbarëvajtjen e procedimit penal. Në këtë kontekst dhe në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata rithekson se u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit dhe se ajo duhet të konsiderohet si mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

99. Në gjykimin kushtetues lidhur me nevojën e ndërhyrjes në të drejtat kushtetuese të kërkuesit, Gjykata analizon fillimisht nëse masa konkrete e sigurimit e vendosur për të (kërkuesin) është e nevojshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm të mbarëvajtjes së procedimit penal në kuadër të të cilit ajo është vendosur. Më tej, Gjykata vlerëson nëse masa e vendosur është e përshtatshme për të realizuar këtë qëllim. Së fundi, Gjykata vlerëson nëse qëllimi i ligjshëm i mbarëvajtjes së procedimit penal mund të arrihej me vendosjen e masave më pak të ashpra.

100. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 520/2023, ka arsyetuar se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimet që vijnë si rezultat i zbatimit të vendimeve nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të po asaj gjykate, duke mos u paraqitur asnjëherë përpara Policisë Gjyqësore. Sipas asaj gjykate, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, i KPP-së), se ai është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se nuk ka zbatuar në mënyrë të përsëritur detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore/hetuesit dhe duke mos paraqitur asnjë arsye të qenësishme që të justifikojë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar, gjithashtu, se në rastin konkret, nevojat e sigurimit vijojnë të jenë në të njëjtin stad, por duke qenë se nga ana e kërkuesit, në mënyrë të përsëritur, janë shkelur detyrimet për zbatimin e masave të sigurimit personal të caktuara nga gjykata, në raport me parashikimet e nenit 228, pika 3, të KPP-së, është para kushteve kur duhet të zëvendësohen masat e sigurimit të dhëna ndaj tij, me një masë tjetër më të rëndë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuesit, lidhur me rrezikun e dëmtimit të provave për sqarimin e fakteve penale, janë të tilla që të justifikojnë masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", për shkak të funksionit që ka ushtruar më parë shtetasi nën hetim në kohën e kryerjes së veprës penale, por edhe funksionit të tij aktual si deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistojnë akoma rrethanat që kërkuesi mund të largohet. Për këto arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke marrë në konsideratë mosrespektimin e urdhërimeve të gjykatës nga kërkuesi, të përcaktuara në vendimin e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj tij, e shoqëruar edhe me ekzistencën e kushteve dhe kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të normuara në nenin 228 të KPP-së, ka vlerësuar se justifikohet zëvendësimi i masave të sigurimit personal nga "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" në masën "Arresti në shtëpi" (*shih faqet 35-39 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

101. Po kështu, GJKKO-ja e Apelit në arsyetimin e saj ka vlerësuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka interpretuar dhe zbatuar ligjin procedural penal korrektësisht, se ky zëvendësim i masës së sigurimit personal vjen në zbatim të kombinuar të neneve 231 me 260, pika 3, të KPP-së, që kërkojnë verifikimin e shkeljes së detyrimeve që burojnë nga masa e sigurimit në fuqi të lidhura me rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes së kryer. Edhe sipas GJKKO-së së Apelit, kërkuesi

ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij, urdhërime që nisur nga natyra e masës së sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", në ditë dhe orë të caktuara, e parespektuar asnjëherë nga ai, që prej lindjes së detyrimit përkatës, dëshmon për rëndësinë e shkeljes, ndërsa në vlerësim të motiveve dhe rrethanave të shkeljes së kryer, rezulton se ato nuk janë objektive dhe në lehtësim të pozitës së shkelësit. Në këtë kuptim, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar drejt dhe në lidhje elementet provuese që përligjin caktimin e një mase më pak shtrënguese personale dhe aktualisht zëvendësim *in peus* të saj, pasi ka vlerësuar qëndrueshmërinë e kushteve të përgjithshme, nevojat e sigurimit të të hetuarit dhe mungesën e shkaqeve të padënueshmërisë ose të shuarjes së veprës penale për të cilën dyshohet. Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi" është në përputhje me kërkesat e nenit 229, pika 2, të KPP-së, që i referohet kriterit të proporcionalitetit ose përzgjedhjes së masës së sigurimit personal në raport të drejtë mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale të atribuar ose dënimit të mundshëm (*shih faqet 16 e vijuese të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

102. Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenet 231 dhe 260 të KPP-së, për zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është arsyetuar dhe vlerësuar drejt nga të dyja gjykatat, të cilat kanë verifikuar shkeljen e detyrimeve që burojnë nga masa e sigurimit personal në fuqi në raport me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes së kryer (pranuar si të tillë nga të dyja gjykatat). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, masa e sigurimit është zëvendësuar *in peius* ndaj kërkuesit në zbatim të neneve 231 dhe 260, pika 3, të KPP-së, për shkak se ai ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij dhe jo për shkak se nevojat e sigurimit janë rënduar. Kolegji Penal, në vlerësimin e tij, ka arsyetuar se gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë vijimësinë e nevojave të sigurimit të evidentuara në gjenezë të caktimit të masës së sigurimit personal, sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së dhe arsyen e zëvendësimit të llojit të masës së sigurimit personal, për shkakun e evidentuar qartësisht në arsyetimin e vendimmarrjes së tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal ka vlerësuar se të dyja gjykatat kanë analizuar dhe evidentuar vijimësinë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm që kërkuesi ka kryer një vepër penale, kusht ky *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të një mase sigurimi personale. Sipas atij kolegji, gjykatat më të ulëta kanë i vlerësuar aktuale nevojat e sigurimit duke evidentuar "shmangien e dëmtimit të hetimeve" dhe "ikjen e kërkuesit" (dy rreziqe të evidentuara që në gjenezë), si dhe kanë arsyetuar përshtatshmërinë e llojit të masës shtrënguese "Arresti në shtëpi" me nevojat e sigurimit sipas rrethanave të rastit konkret. Kolegji Penal ka arsyetuar edhe në lidhje me ndalimet e urdhëruara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për të mos komunikuar me persona të tjerë përveç atyre që bashkëjetojnë me të në banesë, të cilat, sipas atij kolegji, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimmarrjes objekt rekursi (*shih paragrafët 54 e vijues të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

103. Lidhur me nevojën e ndërhyrjes në të drejtat kushtetuese të kërkuesit, nëse masa konkrete e sigurimit e vendosur mbi të (kërkuesin) është e nevojshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm të mbarëvajtjes së procedimit penal në kuadër të të cilit ajo është vendosur dhe nëse është e përshtatshme për të realizuar këtë qëllim, si edhe nëse qëllimi i ligjshëm i mbarëvajtjes së procedimit penal mund të arrihej me vendosjen e masave më pak të ashpra, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

104. Kështu, sipas njërit qëndrim, masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", e caktuar ndaj kërkuesit, nuk ka qenë proporcionale ndaj duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës për këtë shkak[6].

---

[6] Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët Holta Zaçaj, Genti Ibrahimi dhe Marjana Semini.

105. Në linjë me këtë qëndrim, dy gjyqtarë[7] mbajtën qasjen se në caktimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj kërkuesit gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë ekzistencën e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenet 228 dhe 229 të KPP-së për caktimin e masave të sigurimit personal në raport me parashikimet e nenit 260, pika 3, të KPP-së. Sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së, masat e sigurimit personal vendosen kur: *i)* ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; *ii)* i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; *iii)* për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Kurse sipas nenit 229 të KPP-së, në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret dhe çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Nga ana tjetër, sipas nenit 260, pika 3, të KPP-së, kur nevojat e sigurimit rëndohen ose personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtrënguese ose ndaluese shtesë. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë caktimin e një mase ndaluese shtesë ose zëvendësimin e saj me një masë shtrënguese. Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite (neni 260), rezulton se në rastin e masave shtrënguese, që është edhe rasti konkret: *së pari,* zëvendësimi i një mase personale sigurimi mund të vendoset si kur bëhet fjalë për rëndimin e nevojave të sigurimit, çka nënkupton se masa e mëparshme nuk u përgjigjet më atyre, ashtu edhe në rastin e mosekzekutimit të detyrimeve që lindin nga masa e sigurimit; *së dyti,* ajo nuk vendos asnjë detyrim për gjykatën për zëvendësimin ose caktimin e një mase tjetër sigurimi; *së treti,* edhe në rast se gjykata pranon kërkesën e prokurorit ajo vlerëson rast pas rasti nëse nevojat e sigurimit kërkojnë zëvendësimin me një masë tjetër më të rëndë ose caktimin e një mase shtesë. Për rrjedhojë, jo vetëm në kuptim të kësaj dispozite, por edhe në kuptim të dispozitave të tjera procedurale penale që lejojnë caktimin e një mase sigurimi, veçanërisht në rastin kur gjykata investohet për zëvendësimin e një mase për shkak se nuk janë zbatuar detyrimet e saj, nuk kërkohet dhe nuk imponohet caktimi i një mase kufizuese si ajo e arrestit, e cila duhet të mbetet si *ultima ratio,* por nënkuptohet realizimi i një procesi vlerësimi dhe analize nga gjykatat e zakonshme në drejtim të nevojës për zëvendësimin e masës së mëparshme me një më të rëndë, ashtu edhe në drejtim të përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së re me nevojat e sigurimit në momentin e caktimit të saj.

106. Thënë sa më sipër, në rastin konkret gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të arsyetojnë se përse masa e arrestit në shtëpi ishte në rastin konkret e vetmja masë që mund të siguronte mbarëvajtjen e procedimit penal dhe mosvënien në rrezik të tij, pavarësisht se ajo është *ultima ratio*. Në kohën e caktimit të masës së sigurimit personal "Detyrimi për t`u paraqitur në policinë gjyqësore", gjykatat kanë konkluduar se ajo ishte masa e përshtatshme për plotësimin e nevojave të sigurimit në procedimin penal ndaj kërkuesit, çka do të thotë se ato kanë vlerësuar se nuk ekzistonte në atë moment asnjë rrezik për helmimin e provave ose shmangien e drejtësisë nga kërkuesi, dhe për këtë shkak nuk u caktua masa e arrestit. Zëvendësimi i kësaj mase sigurimi është kërkuar nga prokurori jo për shkak të rëndimit të nevojave të sigurimit, pra për shkak të ndryshimit të tyre krahasimisht me momentin e caktimit të masës së parë, por për shkak se kërkuesi nuk ka ekzekutuar detyrimin për t`u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore në ditën dhe orën e përcaktuar për të nga gjykata, çka do të thotë se nuk kanë ndryshuar ata faktorë përcaktues, të tillë që vënë në rrezik vetë procedimin penal (helmimi i provave ose rreziku i ikjes). Pavarësisht kësaj, gjykatat, në kuptim të përmbajtjes së nenit 260, pika 3, të KPP-së dhe nenit 231 të po këtij kodi, që përcaktojnë llojet e masave shtrënguese, nuk kanë arsyetuar në drejtim të nevojës së zëvendësimit të masës me një më të rëndë dhe as në drejtim të përshtatshmërisë së masës së arrestit

[7] Ishin të këtij vlerësimi gjyqtarët Holta Zaçaj dhe Genti Ibrahimi.

në shtëpi, pra se përse ishte masa e vetme në rastin konkret dhe se përse nuk ishte i përshtatshëm caktimi i një mase sigurimi shtrënguese tjetër ose ndaluese shtesë.

107. Referuar përmbajtjes së vendimeve të gjykatave të zakonshme rezulton se ato kanë analizuar vetëm ekzistencën e "dyshimit të arsyeshëm" se kërkuesi është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe, sipas tyre, moszbatimi në mënyrë të përsëritur i detyrimeve që i ngarkohen nga ligji procedural penal dëshmon rëndësinë e shkeljes. Po kështu, nga njëra anë, gjykatat kanë pranuar se nevojat e sigurimit vijojnë të jenë në të njëjtin stad dhe mosrespektimi i detyrimeve që përmban masa e sigurimit personal në fuqi "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" në ditë dhe orë të caktuara, që prej lindjes së këtij detyrimi, dëshmon për rëndësinë e shkeljes, ndërsa në vlerësim të motiveve dhe rrethanave të shkeljes së kryer, rezulton se ato nuk janë objektive dhe në lehtësim të pozitës së shkelësit. Nga ana tjetër, gjykatat janë shprehur se nevojat aktuale të sigurimit, që janë "shmangia e dëmtimit të hetimeve" dhe "ikja e kërkuesit", e bëjnë të përshtatshme me nevojat e sigurimit llojin e masës shtrënguese "Arresti në shtëpi" sipas rrethanave të rastit konkret. Këto qëndrime të gjykatave janë kontradiktore, për sa kohë që qartësisht masa e sigurimit në rëndim të pozitës së kërkuesit lidhet vetëm me mosekzekutimin e detyrimeve që kanë lindur nga masa e mëparshme, ndërkohë që qartësisht nevojat e sigurimit nuk kanë ndryshuar që prej momentit kur është caktuar ajo masë, pra nuk kanë ndryshuar duke u rënduar dhe nuk arsyetohet se cilat janë ato rrethana të reja që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave të këtij procedimi (ose helmimin e provave) apo shmangien e drejtësisë. Në këtë kuptim, gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të arsyetojnë në drejtim të proporcionalitetit elementet që duhet të analizohen prej tyre gjatë caktimit të një mase sigurimi, pra se përveçse e nevojshme, masa e arrestit në shtëpi ishte edhe përshtatshme dhe proporcionalisht e ashpër, pra se asnjë masë tjetër shtrënguese nuk do të ishte në gjendje të siguronte mbarëvajtjen e procedimit penal dhe mosvënien në rrezik të tij.

108. Sipas qasjes së gjyqtares tjetër[8], që ka mbajtur qëndrimin se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" nuk ka qenë proporcionale, në analizën e kushteve dhe kritereve për zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më rënduese siç është "Arresti në shtëpi", duhej të analizohej nëse zëvendësimi ishte i nevojshëm, proporcional, i justifikuar, i përshtatshëm dhe nëse masa rrezikonte të ishte më e ashpër kundrejt qëllimit. Ndonëse kërkuesi ka dëshmuar mospërmbushje të masës së sigurimit "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", përsëri në analizë të nenit 231 të KPP-së vërehet se qëllimi i normës është të parashikojë zëvendësimin me një masë sigurimi më të rëndë, si një *mundësi* dhe jo si një detyrim. Prandaj, Prokuroria e Posaçme mund të kishte treguar një kujdes të shtuar për të nxitur kërkuesin për përmbushjen e detyrimeve ligjore, qoftë edhe duke parë ndonjë alternativë zgjidhjeje për të aplikuar kundrejt një afati të shkurtër me efekt nxitës kombinimin e një mase shtrënguese me një masë ndaluese. Ndonëse në pamje të parë dhe teorikisht rezulton se zëvendësimi i masës është kryer në mbështetje të nenit 228 të KPP-së, përsëri gjykatat e posaçme për të konkluduar për përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin duhet të analizonin *edhe* ndikimin e rrethanave të rastit konkret për mirëfunksionimin e demokracisë në vend. Në këtë këndvështrim, në analizë të: (i) *statusit/cilësive individuale të kërkuesit* të lidhura me rolin e tij në shoqëri, me moshën dhe personalitetin, vërehet lehtësisht se kërkuesi gëzon një status të dyfishtë juridik: si individ dhe si lider i partisë më të madhe opozitare. Ndërkohë, në analizë të: (ii) *kontekstit të situatës aktuale politike e sociale* rezulton se koha kur është caktuar masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" përkon me periudhën e përgatitjes për zgjedhje të përgjithshme parlamentare, gjatë së cilës normalisht forcat politike planifikojnë një plan masash për përgatitjen e fushatës elektorale, takime me zgjedhësit, angazhime mediatike etj. Kalimi i drejtpërdrejtë te një masë rënduese që sjell tashmë heqjen e lirisë ndaj kreut të opozitës passjell vënien në dyshim jo vetëm të garantimit të konkurrimit politik dhe procesit të zgjedhjeve, por edhe vetë mirëfunksionimin e pluralizmit politik dhe demokracisë në vend. Ndonëse në vendimin nr. 81/2024 është mbajtur qëndrimi që

[8] Ishte e këtij vlerësimi gjyqtarja Marjana Semini.

masa e sigurimit "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" është proporcionale në drejtim të përshtatshmërisë, sepse nga intensiteti i saj nuk e pengonte kërkuesin të përmbushte detyrimet e tij qytetare dhe politike, në rastin konkret përshkallëzimi në drejtim të masës "Arresti në shtëpi" (*e cila bie nën spektrin e masave që kufizojnë lirinë personale*) ka rënduar pozitën e kërkuesit, duke e "penalizuar" atë në një mënyrë më të ashpër se sa do të ishte e justifikuar, e arsyeshme, e përshtatshme dhe e nevojshme. Në konkluzion, sipas qëndrimit të kësaj gjyqtareje, zëvendësimi i masës me "Arresti në shtëpi" si joproporcionale në drejtim të ashpërsisë së saj dhe, për rrjedhojë, pretendimin e kërkuesit të bazuar.

109. Ndërkohë, sipas qëndrimit tjetër, neni 27, pika 1, i Kushtetutës kërkon, së pari, që heqja e lirisë të jetë sipas procedurës së përcaktuar me ligj, që do të thotë se çdo privim i lirisë, nga njëra anë, duhet të bazohet në një normë ligjore substanciale dhe sipas rregullave ligjore procedurale, ndërsa, nga ana tjetër, duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 27, pra të mbrojë individin nga arbitrariteti. Me pak fjalë, në parim, heqja e lirisë është e ligjshme nëse kryhet me vendim gjykate. Në vijim, neni 27, pika 2, i Kushtetutës përmban një listë shteruese të rasteve të lejueshme të heqjes së lirisë, që janë në të njëjtën linjë me ato të nenit 5, paragrafi 1, të KEDNJ-së. Për këtë të fundit, GJEDNJ-ja ka pohuar se zbatueshmëria e njërit rast nuk e përjashton domosdoshmërisht një rast tjetër; paraburgimi, në varësi të rrethanave, mund të justifikohet sipas më shumë se një shkaku të parashikuar në nënparagrafët e nenit 5 (*shih Gatt kundër Maltës, datë 27.7.2010, §35; Enhorn kundër Suedisë, datë 25.1.2005, § 34; Eriksen kundër Norvegjisë, 27.5.1997, § 76*). Në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete, duhet evidentuar se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" ndaj kërkuesit është caktuar me vendim gjyqësor jo vetëm për shkak të dyshimit të arsyeshëm të kryerjes së veprës penale (neni 27, pika 2, shkronja "c"), por edhe për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës (neni 27, pika 2 ,shkronja "b").

110. Neni 27, pika 2, shkronja "b", i Kushtetutës lejon kufizimin e lirisë kur një urdhër i ligjshëm i gjykatës nuk zbatohet, që do të thotë se gjykata mund të vendosë heqjen e lirisë së individit për të realizuar qëllimin e urdhrit të ligjshëm të gjykatës, që nuk është zbatuar dhe jo për të ndëshkuar individin. Për këtë arsye, është me rëndësi vendimtare gjetja e ekuilibrit të duhur midis rëndësisë që ka në një shtet të së drejtës zbatimi i urdhrave të ligjshme të gjykatës dhe lirisë personale. GJEDNJ-ja, në gjykime të ngjashme, ka pohuar se çështja e proporcionalitetit merr rëndësi të veçantë në vlerësimin e përgjithshëm të situatës. Qëllimi i vendimit, mënyra e zbatimit të vendimit dhe kohëzgjatja e paraburgimit janë çështje që duhet të merren në konsideratë (*shih Gatt kundër Maltës, datë 27.7.2010, § 40*). Po ashtu, natyra e detyrimit ligjor që rrjedh nga vendimi gjyqësor, duke përfshirë objektin dhe qëllimin e tij thelbësor, personin që ndalohet, rrethanat e veçanta që çuan në paraburgim dhe kohëzgjatjen e ndalimit janë të rëndësishme (*shih Vasileva kundër Danimarkës, nr. 52792/99, §§ 36-38, 25 shtator 2003*).

111. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, fillimisht vlen të theksohet se objekti i këtij gjykimi kushtetues lidhet *vetëm* me procesin gjyqësor për zëvendësimin e dy masave të sigurimit me atë të arrestit në shtëpi ndaj kërkuesit, pra me caktimin dhe jo me kohëzgjatjen e masës së arrestit në shtëpi. Lidhur me këtë të fundit, kërkuesi nuk ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues dhe as nuk ka treguar që i ka shteruar paraprakisht mjetet juridike në dispozicion, pra duke i ngritur ato paraprakisht te gjykatat e zakonshme. Kërkuesi ka zgjedhur që pretendimet e tij për masat e sigurimit të caktuara në të njëjtin procedim penal t'i paraqesë në Gjykatë përmes ankimeve kushtetuese të veçanta për secilin proces gjyqësor, siç ishte rasti për caktimin e dy masave të sigurimit dhe për zëvendësimin e tyre me atë të arrestit në shtëpi, ndërsa mbetet e hapur mundësia për procesin e tretë gjyqësor për zëvendësimin e masës së arrestit në shtëpi, që është në shqyrtim e sipër në gjykatat e zakonshme.

112. Në vijim, duke analizuar në tërësi të dhënat e çështjes konkrete në raport me standardet kushtetuese, nxirret përfundimi se gjykatat e zakonshme fillimisht kanë caktuar ndaj kërkuesit masat e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", duke mbajtur në konsideratë jo vetëm rëndësinë e lirisë personale, por edhe mundësinë e

ushtrimit të funksionit të deputetit në kuadër të së drejtës për t'u zgjedhur. Në këtë kuptim, me vendimin gjyqësor për caktimin e këtyre dy masave, gjykatat kanë nxjerrë urdhrin e ligjshëm që kërkuesi të paraqitej një herë në dy javë në Policinë Gjyqësore, por ky urdhër i ligjshëm u refuzua të zbatohej nga kërkuesi të paktën 4 herë radhazi, në datat 6.11.2023, 20.11.2023, 4.12.2023 dhe 18.12.2024. Duke mos zbatuar këtë urdhër të gjykatës, kërkuesi vuri në dyshim përmbushjen e qëllimit të ligjshëm, për të cilin ishin caktuar masat e sigurimit – konkretisht atë të mbarëvajtjes së procedimit penal ndaj tij, duke theksuar se mbarëvajtja e procedimit penal i shërben ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike. Po ashtu, refuzimi publik për të zbatuar vendimin e gjykatës nga kërkuesi, në cilësitë e tij personale të deputetit dhe të drejtuesit të një force të rëndësishme politike, vë në dyshim parimin e shtetit të së drejtës, i cili bazohet në ndarjen e pushteteve dhe kërkon respektimin e vendimeve gjyqësore.

113. Për arsyet e mësipërme, gjykatat e zakonshme kanë zbatuar në mënyrë të saktë dhe me mirëbesim zëvendësimin e dy masave të sigurimit në atë të arrestit në shtëpi ndaj kërkuesit, duke vendosur ekuilibrin e duhur midis qëllimit për zbatimin e urdhrave të gjykatës, si dhe rëndësisë së lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale vazhdonte të ekzistonte dhe në shtesë të tij kërkuesi nuk kishte përmbushur urdhrin e ligjshëm të gjykatës 4 herë radhazi, duke lënë pa efekte masën e sigurimit të detyrimit për paraqitje në Policinë Gjyqësore. Nga ana tjetër, vlen të përmendet se legjislacioni procedural penal (neni 232 i KPP-së) si masë përshkallëzuese përpara asaj të arrestit në shtëpi parashikon dhe atë të garancisë pasurore, por ajo mund të caktohet *vetëm* nëse nga personi nën hetim ose një person tjetër për të ofrohet garanci pasurore (neni 236, pika 1, i KPP-së), që nuk ka ndodhur në rastin konkret. Si përfundim, nisur nga rrethanat konkrete të çështjes në fjalë, kufizimi i lirisë së kërkuesit përmes masës së sigurimit të arrestit në shtëpi ishte proporcional[9].

114. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit në drejtim të procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit dhe parimit të paanshmërisë, si aspekte procedurale të të drejtave substanciale, janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit. Kurse për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e lirisë personale dhe të drejtës për të ushtruar veprimtarinë parlamentare, në aspektin e proporcionalitetit të masës, në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, ai konsiderohet i rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 17.1.2025.
Shpallur, më 6.3.2025.

Kryetare pjesërisht kundër: Holta Zaçaj

[9] Votuan për rrëzimin e kërkesës për këtë shkak gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Ilir Toska.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci
Anëtarë kundër: Sonila Bejtja
Anëtarë pjesërisht kundër: Genti Ibrahimi, Marjana Semini